

RAPORT I VEÇANTË

**(Zhvendosja e komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur në zonën e
Liqenit Artificial, Tiranë)**

Tiranë ____/____/2016

Përmbajtja:

- 1. Hyrje.**
- 2. Parime ndërkombëtare për zhvendosjen me forcë.**
- 3. Rekomandimi drejtuar Bashkisë Tiranë për trajtimin e rastit të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë.**
- 4. Zhvillime pas paraqitjes së rekomandimit të Avokatit të Popullit në terren. Ankesat e banorëve të komunitetit rom.**
- 5. Korrespondenca me institucione të tjera të përfshira në çështje.**
- 6. Situata pas zhvendosjes**
- 7. Konkluzione.**

1. Hyrje:

Romët janë një grup etnik unik, i njohur zyrtarisht si minoritet etno-gjuhësor, i vendosur në territoret shqiptare prej kohësh dhe që ja ka dalë mbanë të ruajë gjuhën dhe kulturën e tij. Gjatë periudhës së tranzicionit post-socialist, si rezultat i kolapsit dhe mbylljes së ndërmarrjeve shtetërore dhe për shkak të karakterit e të aftësive të tyre, si dhe niveleve të ulëta të arsimimit, pa përjashtuar këtu diskriminimin, Romët kanë kaluar nga një gjendje relativisht e mirë, në varfëri të skajshme. Ata mund të konsiderohen për momentin, grupi etnik më i varfër dhe më i mënjanuar në Shqipëri.

Sitet e njohura Rome në vend ndodhen në, Tiranë,¹ Lezhë, Mamurras, Fushë-Krujë, Nishtullë të Durrësit, Peqin, Rrogozhinë, Peqin, Cërrik, Rrapishta në Elbasan, Pogradec, Korçë Bilisht, Levan, fshati Rom në Fier, Grabian i Lushnjës, Kuçovë, Berat, etj. Ndërkohë duhet theksuar se ka dhe site të tjera të qëndrueshme, të krijuara së fundmi, pas viteve '90, ku përmendim sitet në Shkodër, Gjirokastrë, Delvinë, Beltojë, Ura e Drojës, Kukës, Peshkopi, Shupenzë të Peshkopisë, Milot, Ura e Dajlanit, Vriion të Sarandës, Kthesa e Ariut në Durrës, Fushë Alie, etj. Procesi i migrimit të brendshëm që po ndodh me Romët për shkak të kushteve ekonomike, po bën që vendbanimet e tyre të shtrihen në të gjithë Shqipërinë, duke ndryshuar hartën e vendndodhjeve të tyre.

Pavarësisht parashikimeve ligjore në fuqi, të gjithë jemi të vetëdijshëm, që ka shumë për të bërë, për të garantuar në praktikë, respektimin e të drejtave, integritimin dhe përfshirjen sociale, të këtij minoriteti. Sot jemi para momentit për të bërë një zgjedhje historike, ku barazia formale e garantuar në ligj, të mund të kthehet në një barazi reale thelbësore për këtë minoritet i cili, ashtu në qetësinë e tij të përditëshme, por shqetësuese për sytë e një shoqërie demokratike gjithëpërfshirëse, na kujton se pjesa tjetër mazhoritare e popullsisë, i ka lënë “të qetë”, në përjashtimin dhe segregimin e tyre social.

Realiteti i përditshëm që shohim më sytë tanë na ka bërë të reflektojmë thellë dhe të kuptojmë se Romët sot janë një grup vulnerabël dhe në risk, sikurse edhe disa kategori të tjera sociale. Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar prej kohësh problematikat e këtij minoriteti dhe në fakt, pyetja bazë që shtrohet sot nga eksperiencia jonë është nëse realisht Romët janë të përfshirë në sistemin tonë social? Dhe kur flas për këtë sistem kam parasysh, strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimin e ndihmës ekonomike, apo edhe arsimimin, si problemet më kyçe, pa përjashtuar këtu punësimin, formimin

¹ Sitet e njohura në Tiranë ku janë vendosur komunitete të dallueshme Rome aktualisht janë siti Rom në zonën e Bregut të Lumit, dhe siti Rom në zonën e Shkozës. Për shkak të praktikave të zhvendosjes me force nga pronat publike apo edhe private në territorin e Bashkisë Tiranë, sot nuk janë më ekzistente sitet rome të zones së ish Stacionit të Trenit, të zonës në afërsi të “Pallatit me shigjeta”, rruga e Kavajës, apo edhe të zonës së Liqenit Artificial.

profesional, kujdesin shëndetësor dhe çdo beneficë që sistemi ynë social, ua siguron qytetarëve të vet.

Efektivisht mund të thuhet se, sistemi ynë social formalisht i pranon këta individë, por faktikisht i përjashton ata duke u kthyer, në një kështjellë të pakalueshme burokratike dhe sinonim të një refuzimi të pashpallur social.

Në këtë kuadër Avokatit i Popullit ka dërguar një sërë rekomandimesh, ku përmendim rekomandimet:

- Përfshirjen në programet e formimit profesional dhe punësimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom
- Për regjistrimin e pjesëtarëve të minoritetit Rom në regjistrat e gjendjes civile dhe lehtësimin e procedurave të transferimit të të dhënave të gjendjes civile në njësitë vendore ku ata kanë vendbanimin e ri
- Marrjen e masave që do të ndikojnë në aksesin më të mirë në arsim të fëmijëve të minoritetit Rom në Shqipëri;
- Plotësimin e kushteve të përshtatshme për jetesë në ambientet e ish repartit ushtarak të ndodhur në Sharrë, Tiranë, ku pritej të strehoheshin disa familje të minoritetit Rom
- Marrjen e masave për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve të minoritetit Rom, të vendosur pranë ish repartit ushtarak, Sharrë, Tiranë, në shkollat 9 vjeçare, pranë vendbanimit aktual të tyre
- Ndryshimin e Ligjit nr.9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, i ndryshuar
- Ndryshimin e VKM-së nr.787/2005, “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”
- Marrjen e masave për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit etno gjuhësor Rom.
- Disa përmirësime në Ligjin nr.69 datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.
- Disa përmirësime në ligjin nr.10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”. Kemi sugjeruar parashikimin e masave për përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, konkretisht 10221/2010, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit. *(Sipas raportit të ECRi për vitin 2010 dhe rekomandimit që ne si institucion kemi paraqitur për këtë qëllim që në muajin Prill 2013).*
- Plotësimin e kuadrit ligjor, për njohjen dhe mbrojtjen e minoriteteve në vendin tonë, në përputhje me përcaktimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”
- Një grup rekomandimesh për trajtimin e çështjes së problemit të strehimit, për familjet Rome që preken nga ndërtimi i Unazës së Re, për qytetin e Tiranës.
- Dy rekomandime për eliminimin e situatës segreguese ndaj fëmijëve egjiptianë dhe rom, që mësojnë në shkollën 9 vjeçare, publike, “Naim Frashëri”, Korçë, si dhe të fëmijëve rom, që mësojnë në shkollën vartëse “Avdyl Avdia”, Moravë, Berat, me qëllim eliminimin e veçimit fizik të fëmijëve rom dhe egjiptianë, nga fëmijët jo rom dhe jo egjiptianë.

Veç këtyre rekomandimeve Avokat i Popullit ka paraqitur në Kuvend tre Raporte të Veçanta, lidhur me problematikat e minoritetit Rom në Shqipëri.

1. Raporti i veçantë dërguar Kuvendit mbi të drejtat e minoritetit Rom, sipas problematikave të konstatuara gjatë aktiviteti të Avokatit të Popullit, gjatë 6 muorit të parë të vitit 2012.
2. Raporti i veçantë dërguar Kuvendit të Shqipërisë në fillim të vitit 2014 mbi gjendjen e të drejtave të minoritetit Rom në vend, pas një inspektimi të të gjitha siteve kryesore të Romëve, në Shqipëri.
3. Raporti i veçantë dërguar Kuvendit të Shqipërisë në fillim të vitit 2015, mbi gjendjen e të drejtave kolektive të minoriteteve në Shqipëri, ku natyrshëm përfshihet edhe gjendja e të drejtave kolektive të minoritetit Rom.

Elementët më kryesorë në zgjidhjen e çështjeve me të cilat përballlet sot shoqëria shqiptare, përfshirë çështjet e minoritetit Rom, janë dialogu konstruktiv dhe i vazhdueshëm, si dhe bashkëpunimi ndërkulturor ndërmjet, institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe qytetarëve, me qëllim që adresimi i problematikave dhe procesi i analizimit dhe zgjidhjes së tyre të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i gjithë pranuar. Përmbushja e detyrimeve që Shqipëria ka në kuadër të respektimit të të drejtave të minoriteteve, veçanërisht ndaj minoritetit Rom, me qëllim që ky komunitet të jetojë me standardet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, kërkon koordinim ndërinstitucional, me rëndësi thelbësore për mbrojtjen efektive të të drejtave të tij.

Problematikë shqetësuese mbetet çështja e zhvendosjes së komuniteteve rome (por edhe egjiptiane), nga vendqëndrimet e tyre të vendosura në prona publike apo edhe private, sikurse ka ndodhur edhe me komunitetin Rom/Egjiptian, të vendosur prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Janë disa raste të evidentuara që lidhen me këtë problematikë nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat rasti më i fundit që lidhet me zhvendosjen e komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, trajtohet në këtë raport të veçantë.

2. Parime ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave kundër zhvendosjes me forcë (lirimit me forcë të banesës).

E drejta për strehim u përmend së pari në një akt të rëndësishëm ndërkombëtar në vitin 1948, me afirmimin e saj në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Më pas, kjo e drejtë është riafirmuar në një sërë instrumentash të tjerë ndërkombëtarë si:

- Konventa e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore (ICESCR), ku u kërkohet vendeve anëtare të marrin të gjitha masat e nevojshme për të nxitur realizimin e së drejtës për strehim të përshtatshëm.
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit, kundër Grave (CEDAW).
- Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (CRC).
- Konventa për Statusin e Refugjatit, ku parashikohen gjithashtu dispozita për të drejtën për strehim.

Në Komentin e Përgjithshëm nr.4, për të drejtën për një strehim të përshtatshëm, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike

Sociale dhe Kulturore, struktura e Kombeve të Bashkuara e krijuar për monitorimin e zbatimit të ICESCR, parashikon elementët përbërës të së drejtës për strehim. Sipas CESCO, e drejta për strehim nuk duhet barazuar me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet parë si e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore thekson gjithashtu se, e drejta për strehim u duhet garantuar të gjithë personave, pavarësisht të ardhurave të tyre, dhe duhet zbatuar në një mënyrë të tillë që të përputhet me mundësitë e tyre. Ajo duhet të nënkuptojë për shembull se jo vetëm qiraja, por edhe kostot që lidhen me strehimin (si energjia dhe uji) duhen përcaktuar të tilla që, pjesa e mbetur e të ardhurave të personit të jetë e mjaftueshme për t'i përballuar nevojat e tjera bazike. Po sipas këtij Komiteti, e drejta për strehim është një e drejtë e shumëanëshme, e cila përbëhet nga shtatë aspekte të cilat duhen përmbushur në mënyrë që të zbatohet plotësisht kjo e drejtë. Këto aspekte janë:

- a) Siguria ligjore e posedimit/zotërimit;
- b) Mundësia (shërbimeve, materialeve, dhe infrastrukturës);
- c) Përballueshmëria
- d) Jetueshmëria
- e) Aksesshmëria
- f) Vendodhja, (e cila duhet të lejojë akses në tregun e punës, shëndetësi, arsim, kujdes për fëmijët, dhe lehtësira të tjera sociale) dhe,
- g) Përshtatshmëri kulturore.

Në këtë kuadër Komiteti ka vendosur se, detyrimet për shtetet anëtare janë të dyanshme. Së pari, shtetet duhet të miratojnë të gjitha masat e nevojshme ligjore, administrative, financiare, edukative, dhe sociale të cilat mundësojnë realizimin e të drejtës në strehim; së dyti disa detyrime janë menjëherë të detyrueshme ndaj shteteve, pavarërisht nivelit të tyre të zhvillimit; ato përfshijnë parashikimin dhe ndalimin e diskriminimit, hartimin e strategjive dhe monitorimin e nivelit të zbatimit të së drejtës për strehim. Me fjalë të tjera mugesat në fondet publike nuk mund të përdoren si shfajësim dhe justifikim për mos marrjen e asnjë mase për zbatimin e kësaj të drejte. Edhe vendet që përballen me vështirësi të mëdha financiare duhet të miratojnë programet e përshtatshme që janë eficientë në kosto për pjesën më vulnerabël të shoqërisë. Nëse një numri të konsiderueshëm individësh në një shtet u mohohet strehimi bazik, atëherë shteti në fjalë mund të konsiderohet se ka dështuar në plotësimin e detyrimeve në bazë të Konventës së të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore.

Mbi këtë bazë vlerësimi, njihet si detyrim i shteteve fakti që, miratimi i çdo mase me efekt përkeqësues duhet justifikuar plotësisht. Kështu mohimi i individëve, apo ofrimi i strehimit nën kushtet e tyre, pa i ofruar strehim të paktën në të njëjtin nivel mund të konsiderohet si masë përkeqësuese. Një çështje tjetër lidhur me të drejtën për strehim është vënia e drejtësisë, domethënë nëse ajo mund të mbrohet përpara gjykatave.

Në çdo rast duhet theksuar se të gjitha këto parime reflektohen gjithashtu edhe në Rekomandimin e Komitetit të Këshillit të Evropës, Rec. (2005)4 “Për Përmirësimin e Kushteve të Strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Europë”.

-E drejta për strehim dhe mbrojtja nga lirimi me forcë i banesës Një nga komponentët e së drejtës për strehim të përshtatshëm, konkretisht siguria ligjore e posedimit, ka për qëllim mbrojtjen juridike të të gjithë personave kundër

lirimit me forcë, një detyrim të cilin duhet ta zbatojnë shtetet anëtare menjëherë dhe pavarësisht gjendjes së tyre financiare.

Me anë të Komentit të Përgjithshëm nr. 7 mbi të drejtën për një strehim të përshtatshëm; lirimi me forcë, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore ofron udhëzime të qarta për dy çështje të lidhura me njëra tjetrën: *siguria ligjore e posedimit* dhe *lirimi me forcë*.

Komiteti e përkufizon **lirimin me forcë** si “lirim i përhershëm apo i përkohshëm kundër vullnetit të individit, familjes, komunitetit, të shtëpive dhe/ose i tokës të cilën ato kanë zënë, pa i ofruar dhe pa i siguruar mënyra ligjore dhe mënyra të tjera mbrojtjeje.” Ndërsa vihet në dukje se dëbimi është në përgjithësi në kundërshtim me Konventën e të Drejtave Ekonomike Sociale dhe Kulturore, në të njëjtën kohë është bërë gjithashtu e ditur se, ato mund të justifikohen (psh në rastet e mospagimit të vazhdueshëm të qirasë kur vërtetohet se personi në fjalë ka të ardhura të mjaftueshme në dispozicion për të mbuluar kostot e qirasë), në rast se ato plotësojnë një numër kushtesh (si konsultimi paraprak me personin që do të dëbohet, njoftimi i përshtatshëm dhe i arsyeshëm për kohën se kur do të lirohet pasuria dhe ofrimi i mjeteve mbrojtëse për parandalimin e dëbimit ose për kompensimin). Këto kërkesa zbatohen në të njëjtën mënyrë si në rastet e dëbimeve të kryera nga autoritet shtetërore edhe dëbimet e kryera nga privatët. Lirimet e banesave nuk duhet ta kthejnë personin në të pastrehë dhe nuk duhet ta bëjnë atë vulnerabël ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, ato nuk duhen bërë në kohë të keqe ose gjatë natës.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore shpreh shqetësimin e tij se, lirimi me forcë shoqërohet zakonisht nga akte dhune (ndonjëherë lirimi ndodh gjatë dhunës ndër-etnike) dhe gratë, fëmijët dhe minoritetet janë veçanërisht vulnerabël. Kjo nënkupton që autoritet duhet të konsultohen me ata që preken përpara se të bëhet nxjerrja e tyre, si edhe t’u ofrojnë atyre asistencë ligjore falas ose t’u ofrojnë vende alternative (në rastin e romëve nomadë), apo strehim. Një keqkuptim i zakonshëm është se mbrojtja nga lirimi me forcë zbatohet vetëm për ndërtesat e përshtatshme që shërbejnë si shtëpi, të cilat janë ndërtuar në përputhje me kriteret e ndërtimit dhe strehimit.

Siç ka theksuar vazhdimisht Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja se nëse disa ndërtime mund të klasifikohen si “shtëpi” është një çështje fakti dhe nuk varet nga ligjshmëria e posedimit, sipas së drejtës së brendshme.² Nga ana tjetër, Komenti i Përgjithshëm nr. 4, i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, orienton shtetet që të garantojnë posedimin e të gjitha formave dhe me një numër në rritje të vendimeve të dhëna nga gjykata ndërkombëtare dhe organet “quasi” gjyqësore,

² Në çështjen *Connors v. GB*, aplikanti, (rom), ishte nxjerrë nga një kamping lokal i ofruar për udhëtarë, i mbajtur nga bashkia dhe në të cilën ai dhe familja e tij kishin qendruar për shumë vite dhe në bazë të një procedure të përmblodhur dëbimi, e cila nuk kërkonte as marrjen e një vendimi gjyqësor për të autorizuar dëbimin. Lirimi i sendit ishte i menjëhershëm dhe nuk mund të ankimohej në gjykatë. Duke vënë në dukje se karvani ishte shtëpia e aplikantit dhe ai dhe familja e tij nuk kishin gëzuar asnjë formë posedimi dhe as nuk ishin lejuar nga e drejta e brendshme për ankimin e dëbimit, Gjykata Evropiane vendosi se lirimi i sendit nga aplikanti nuk u ndoq nga mbrojtja e një procesi të rregullt dhe për pasojë shteti ishte në shkelje të nenit 8 të Konventës. Aplikimi nr. 66746/01, vendimi i 27 Maj 2004. 25 Shih në http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Housing/Guidelines_en.pdf 26 Ibid, paragrafët 17, 22.

konfirmon se të gjitha format e strehimit, pavarësisht se ato përkojnë apo jo me pikëpamjen e shoqërisë lidhur me atë çka përbën një strehim/shtëpi, u duhet ofruar mbrojtje nga dëbimi me forcë.

-Parimet në praktikë. Masat operacionale lidhur me tre fazat e liritimit të banesës.

Duke bërë më të qarta detyrimet e shtetit në rastet e liritimit me forcë të banesave nga komuniteti dhe duke u mbështetur në Komentin e Përgjithshëm nr.7, të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara për strehimin ka publikuar një numër udhëzimesh të detajuara të cilat përmbledhin detyrimet e përgjithshme të shteteve lidhur me strehimin si edhe detyrimin e tyre përpara, gjatë dhe pas liritimit të banesës, të emërtuara, Parimet dhe Udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe *Udhëzimet për Lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen*.

Këto udhëzime kanë për qëllim që të ofrojnë orientime të qarta për zyrtarët dhe politikëbërësit për masat që duhen marrë (legjislative, operacionale), të cilat garantojnë se lirimi i banesës është bërë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Sipas këtyre parimeve dhe udhëzimeve që lidhen me masa të ndryshme, për faza të ndryshme të liritimit të banesës, personave të kërcënuar me, ose që kanë kaluar të gjitha fazat e liritimit të banesës, në të gjitha kohët u duhet garantuar mbrojtje e përshtatshme.

A. Përpara liritimit të banesës Sipas parimeve bazë të Kombeve të Bashkuara, lirimi i banesës duhet konsideruar si mjeti i fundit dhe pasi janë shqyrtuar të gjitha alternativat (siç është rregullimi i banesave) – me fjalë të tjera, barra i mbetet autoriteteve që të provojnë se dëbimi është i pashmangshëm, psh për qëllime të interesit publik/ shëndetit publik. Duhet zhvilluar konsultime të vazhdueshme ku të ftohen të marrin pjesë të gjithë personat e prekur ndërkohë që autoritet duhet të nxisin pjesëmarrjen e grave. Për më tepër, me qëllim që konsultimet të jenë efektive, autoritetet duhet t'u ofrojnë atyre që preken të gjithë informacionin e nevojshëm, informacion si arsytet që lidhen me lirimimin e banesës, oraret e punës që do të kryhen, si edhe dhënien e kohës së nevojshme të atyre që preken dhe avokatëve të tyre për të dhënë alternativat, për të bërë komente/sugjerime, për planet e autoriteteve. Do të ishte ideale që rezultati i këtyre përpjekjeve të ishte përfundimi i një marrëveshjeje midis autoriteteve shtetërore dhe personat që do të lirojnë banesat, e cila rregullon të gjitha aspektet e liritimit të banesës dhe ofron alternativa për strehim. Nëse palët nuk janë gjendje që të arrijnë një marrëveshje të tillë atëherë atyre u duhet ofruar mbrojtje në institucione të tjera si tek gjykatat, apo tek zyra e Avokatit të Popullit.

Nëse lirimi i banesës është i pashmangshëm dhe nuk arrihet asnjë marrëveshje, atëherë vendimi që urdhëron lirimimin e banesës i duhet drejtuar të gjithë individëve të prekur, në një kohë të mjaftueshme përpara se të kryhet lirimi i banesës. Vendimi duhet të përmbajë arsytet e liritimit të banesës, detajet e plota për alternativat dhe kur nuk ofrohen alternativa, detajet e masave që do zbatohen autoritetet me qëllim që të lehtësojnë efektet e liritimit të banesës. Vendimet lidhur me lirimimin e banesave duhet të jenë subjekt i kontrollit gjyqësor, dhe lirimi duhet të lejohet kur ka një çështje përpara gjykatës; personat e kërcënuar për lirimimin e banesës duhet të jenë në gjendje që të ankimojnë lirimimin e banesës në gjykatë dhe duhet tu ofrohet mbrojtje ligjore falas nëse nuk janë

në gjendje të sigurojnë mbrojtje. Për më tepër personave që lirojnë banesën u duhet dhënë kohë e mjaftueshme që ndër të tjera të bëjnë një inventar të posedimeve të tyre në mënyrë që të vlerësojnë vlerën e pronës në rast humbjeje/dëmtimi. Në parim ofrimi thjesht i kompensimit të viktimës që detyrohet të lirojë banesën nuk konsiderohet i mjaftueshëm në rast se nuk shoqërohet me ofrimin e alternative të strehimit. Ata që dëbohen duhen kompensuar edhe për humbjet, shpëtimin dhe transportimin e sendeve të tyre, pavarësisht nëse ishin mbajtës, apo jo të së drejtës së pronësisë; edhe pronarët e pronave informale kanë të drejtën e kompensimit. Është detyrim që lirimi i banesës të mos i kthejë individët në të pastrehë, vulnerabël ndaj shkeljes së të drejtave të tyre të tjera (psh. e drejta për ushqim). Strehimi alternativ duhet t'u ofrohet menjëherë pas lirit të banesës dhe duhet të ndodhet sa më afër që të jetë e mundur vendit të banesës fillestare/mjeteve të jetesës së personit të larguar. Për më tepër, ofrimi i strehimit alternativ duhet të përmbushë kriteret e parashikuara në Komentin e Përgjithshëm nr.4, referuar më sipër, konkretisht sa i përket aksesit, përshtatshmërisë, jetueshmërisë, sigurimit të posedimit, kulturës së përshtatëshme, si edhe përshtatshmërisë së vendndodhjes dhe aksesit tek shërbimet thelbësore.

Sipas Kartës sociale të të Drejtave, e rishikuar, shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantojnë se grupeve vulnerabël si Romëve/udhëtarëve u duhen ofruar mundësi të përshtatshme për të rregulluar strehimin e tyre dhe mos marrja në konsideratë e nivelit të tyre të mohimit përgjatë viteve ku hartohen kërkesat e nevojshme për rregullimin e strehimit mund të çojë në diskriminim të tërthortë. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për t'u dhënë strehim atyre, por edhe për t'i ofruar sigurinë ligjore shtesë, për sa kohë që shtëpitë e paligjshme janë më shumë subjekt i prishjeve. Kështu, Karta thekson se, prishja e shtëpive të paligjshme dhe krijimi i qytetit të barakave mund të jetë rezultat i mungesës së politikave efektive të strehimit. Për pasojë është e papranueshme, për mos thënë e padrejtë, që të penalizosh ata njerëz që nuk kanë asnjë mbështetje nga shteti dhe që janë munduar të rregullojnë problemet e tyre të strehimit me të gjitha mënyrat që ato munden duke ushtruar të drejtën e "vetë-ndihmës". Gjithmonë sipas Kartës: *"...një person ose një grup personash që nuk mund të përfitojnë efektivisht nga e drejta parashikuar në legjislacion, detyrohet që të adoptojë sjellje të papërshtatshme me qëllim që të plotësojnë nevojat e tij më të domosdoshme. Megjithatë kjo rrethanë nuk mund të justifikojë asnjë sanksion apo masë kundër këtyre personave, dhe as nuk mund të mbahet për t'i ndaluar ata nga përfitimi i të drejtave. Megjithatë kjo rrethanë nuk mund të përdoret për të justifikuar sanksionet ndaj këtyre personave, dhe as nuk mund të përdoret për mohimin e vazhdueshëm të përfitimit nga të drejtat e tyre".*³

Një çështje e rëndësishme që lidhet me jetën familjare, por me një element të fortë strehimi që thekson nevojën që autoritet të ndihmojnë ata që jetojnë në kushte strehimi të pasigurta të kapërcejnë problemin e tyre, përkundrajt thjesht penalizimit të tyre është ajo e, *Wallová dhe Walla v. the Czech Republic* (jo një çështje që lidhet me romët/udhëtarët). Gjykata në këtë rast ishte kritike me autoritet sociale që e morën në kujdestari fëmijën e aplikuesit, dhe i vendosën ata në një institucion me arsyen e thjeshtë se situata e tyre e strehimit ishte

³ Ankimi Kolektiv Nr. 31/2005, *Qendra Evropiane e të drejtave të Romëve v. Bullgarisë*, Vendim themeli, miratuar më 18 tetor 2006, shih në http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/socialcharter/Complaints/CC31Merits_en.pdf, paragrafi 53.

problematike –një problem i ndeshur nga shumë Rom, në Republikën Çeke. Gjykata vërejtë se autoritetet duhet të kishin ndihmuar aplikantin që të zgjidhte problemin e strehimit (psh. duke i ofruar atij strehim të përshtatshëm ose duke e ndihmuar që të kishin akses në përfitime të tjera të strehimit), por ai më shumë sesa u mbështet, u ballafaqua me një masë të tillë drastike. Duke iu kthyer çështjes së mbrojtjes kundër vendimit të autoritetit që detyron lirim të banesës, si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara kanë theksuar nevojën për mbrojtje të brendshme, të vazhdueshme, efektive, ndaj atyre që kërcënohen nga lirim, mbrojtje e cila duhet thjesht të konsistojë në sigurimin se a janë ndjekur procedurat e brendshme ligjore dhe se do të shqyrtohet dhe rishikohet përmbatja e secilës prej tyre. Kështu në dy rastet e nxjerrjes së romëve të sjella kundër Bullgarisë, *Yordanova dhe të tjerë v. Bullgarisë*⁴ dhe *Liliana Assenova Naidenova et al v. Bulgaria*,⁵ respektivisht përpara Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe Komitetit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, të dy këto institucione arritën në të njëjtat përfundime.

Të dyja janë raste që thyen akullin në kuptimin që janë rastet e para kur një gjykatë ndërkombëtare nxjerr vendime të ndërmjetme të cilat u kërkojnë autoriteteve që të mos vazhdojnë largimin e komunitetit të romëve deri në shqyrtimin e çështjes së tyre – në të vertetë Komiteti i të Drejtave të Njeriut nxorri një vendim të dytë të ndërmjetëm, i cili u kërkonte autoriteteve që të rilidhnin ujin në shtëpitë e tyre, të cilën autoritet e kishin ndaluar me qëllim që ti kërcënonin dhe detyronin romët që të lironin shtëpinë. Këto vendime jepen vetëm në raste të veçanta, vetëm atëherë ku dëmi i shkaktuar personave është i parekuperueshëm. Me fjalë të tjera të dyja organet konsideruan se nëse do të ndodhte lirim atëherë ai do të kishte pasoja të rënda dhe të dëmshme për jetën e aplikuesve.

Në vendimin e tyre përfundimtar asnjë nga palët nuk e vuri në diskutim faktin se, Romët në fjalë ishin vendosur në mënyrë të paligjshme në tokën publike dhe për pasojë, në parim, largimi i tyre nuk ishte i pajustificuar apo në kundërshtim me ligjin e brendshëm. Për më tepër, Gjykata Evropiane ishte kritike për argumentin e parashtruar se largimi ishte i nevojshëm bazuar në mbrojtjen e shëndetit public, si edhe për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të vetë Romëve. Duke pranuar se Romët jetonin në kushte jo higjienike dhe shëndeti i tyre duhej marrë në konsideratë, zgjidhja e ofruar nga autoritetet (pra largimi i tyre) nuk adresonte në mënyrë të përshtatshme këto çështje, – arsye të mjaftueshme për ta bërë problemin edhe më emergjent.

Të dy autoritet konsideruan të rëndësishme mungesën e ofrimit të çdo forme alternative të strehimit për Romët dhe familjet e tyre gjatë kohës që u lejua dëbimi dhe faktin që autoritet kishin lejuar Romët të jetonin atje për shumë vite dhe nuk mund ti urdhëronin papritur që të largoheshin dhe të ndërprisnin jetën e tyre familjare dhe komunitare, që kishin zhvilluar gjatë viteve.

Për më tepër të dy strukturat theksuan mungesën e mbrojtjes gjyqësore që mund t'i lejonte aplikantëve të ngrinin këto çështje në gjykatat e brendshme dhe vendosi se, shteti nuk arriti që t'u ofronte aplikantëve alternativë strehim përpara se t'u kërkonte atyre që të lironin pronën, ose nuk duhet të kishte proceduar me largimin e tyre.

⁴ Appl. nr. 23848/04, vendimi i 21 Nëntor 2006.

⁵ Appl. nr. 25446/06, vendimi i 24 Prill 2012.

Së fundmi, një argument i parashtruar nga autoritetet shtetërore lidhej me mungesën e çdo lloj kompensimi për pronarët e paligjshëm, pasi shtëpitë e tyre ishin ndërtuar pa leje. Gjykata Evropiane e kapi me shpejtësi këtë argument duke sqaruar se edhe pse i vendosuri, për shembull, në një pronë publike, nuk mund të lejohet gjithmonë të pretendojë pronësinë mbi tokën, ai/ajo mund të pretendojë gjithmonë se shtëpia që ai /ajo ka ndërtuar pa leje krijon një posedim të veçantë mbi tokën mbi të cilën ka ndërtuar dhe në rast humbjeje të saj mund të kompensohet. Duke vendosur kështu, Gjykata e vendosi theksin në dy parametrat e mëposhtëm: së pari, prishja e shtëpive pa leje ishte një problem i njohur në Bullgari dhe se, shtetet në mënyrë të vazhdueshme nxirrnin ligje për të rregulluar ato, me fjalë të tjera, ndërtimet pa leje përbënin një problem strukturor që ishte të paktën i toleruar nga shteti për të mos thënë tashmë i inkurajuar nga shteti. Së dyti, në rastin e aplikantit autoritetet jo vetëm që ishin në dijeni të faktit që shtëpia e tij ishte ndërtuar pa leje por e kishin lejuar atë që të lidhej me shërbimet publike utilitare.

B. Gjatë lirimit të banesës Në rastet kur lirimi i banesës është i pashmangshëm, përvec sa më sipër, autoritetet duhet marrin një numër masash me qëllim që të garantojnë se lirimi është kryer në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Për pasojë lirimi i banesës nuk duhet të bëhet kur është mot i keq, gjatë festimeve fetare, përpara zgjedhjeve, përpara, ose gjatë provimeve të shkollës, gjatë natës, ose kur banuesit nuk ndodhen aty. Zyrtarët shtetërorë të identifikuar qartë duhet të marrin pjesë ndërkohë që, i duhet dhënë akses mediave dhe vëzhguesve të pavarur. Personave që do të lirojnë banesën iu duhet dhënë kohë e mjaftueshme për të mbledhur sendet personale dhe ato nuk duhen detyruar që të dëmtojnë shtëpinë, megjithëse mund të lejohen ta bëjnë këtë nëse ata vetë e kërkojnë (me qëllim që të shpëtojnë materialet e ndërtimit). Autoritetet duhet të mbrojnë gjithashtu çdo lloj prone të lënë mbrapa, dhe të sigurojnë që ajo nuk do të merret forcërisht apo prishet dhe të marrin masa që të mbrojnë mirëqenien e grupeve të pambrojtura siç janë gratë dhe fëmijët.

Së fundmi, çdo përdorim force nga autoritetet duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare të lidhura me përdorimin e forcës. Në çdo rast, natyra dhe shtrirja e masave administrative dhe operacionale që do të merren do të varet nga rrethanat dhe faktet.

C. Pas lirimit të banesës Lirimi i banesës i pashoqëruar me ofrimin e alternativave të strehimit mund të konsiderohet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare vetëm në raste shumë përjashtimore.

Në çdo rrethanë tjetër, autoritetet duhet të sigurojnë se ato që janë nxjerrë jashtë, kanë akses ndër të tjera në strehime dhe shtëpi, si edhe në shërbimet shëndetësore dhe të edukimit, dhe lirimi me forcë nuk duhet të kthejë ata në të pastrehë. Për më tepër autoritetet nuk duhet të injorojnë asnjëherë aspektin gjinor dhe duhet gjithmonë të përpiqen që të nxisin pjesëmarrjen e grave në të gjitha procedurat e nevojshme. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mirëqenies së grave dhe fëmijëve.

Strehimi alternativ duhet të plotësojë të gjitha kriteret e Komentit të Përgjithshëm nr.4, ndër të tjera lidhur me aksesin dhe jetueshmërinë. Autoritetet duhet që të monitorojnë dhe ndjekin kushtet sociale dhe shëndetësore të atyre që shpërngulen (veçanërisht në rastet e shpërnguljes së të gjithë komunitetit) dhe të nxisin marrëdhëniet e mira me komunitetin e ri

pritës. Jurisprudenca e gjerë sugjeron se viktimat e lirit të banimit mund të kenë të drejtë kur refuzojnë ofrimin e një alternative të strehimit nëse ky strehim nuk përmbush kriteret bazë dhe për pasojë nxjerrja nga banesa mundet që përsëri të quhet e jashtëligjshme. Kështu në rastin *Kopnin and Others v. Russia*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kishte parashikuar se aplikanti kishte të drejtë kur nuk kishte pranuar një apartament alternativ që i ishte ofruar atij dhe që ishte i pajetueshëm. Në një çështje tjetër *Winterstein and Others v. France*, që lidhet lirin e banesës nga *Gens du Voyage* (Travellers), Gjykata Evropiane e vuri theksin tek fakti që edhe pse me vonesë, autoritetet kryen një studim social dhe urban me qëllim që të evidentonin nevojat e disa aplikantëve, të cilët pas përfundimit të studimit ishin pajisur me banesa sociale. Megjithatë Gjykata Evropiane gjeti shkelje të nenit 8 në lidhje me ato familje franceze Udhëtare të cilat kërkuan zhvendosje në pronat e familjes, duke arritur në përfundimin se autoritetet nuk kishin arritur që t'u ofronin strehim të përshtatshëm kulturalisht konform mënyrës së tyre të jetesës. Siç u theksua më sipër, përshtatshmëria kulturore është një tjetër element i së drejtës për strehim që shteti duhet marrë në konsideratë kur hartohen politikat e strehimit.

3. Rekomandimi drejtuar Bashkisë Tiranë dhe deklarata për median e datës 8.10.2015, për trajtimin e rastit të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë.

Bazuar në informacionin e marrë nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni të zhvillimeve që lidheshin me ndërhyrjen që parashikohej të ndërmerrej nga ana e Bashkisë Tiranë, për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 2.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve romë/egjiptiane që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë ishte angazhuar me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe është pronë publike.

Po sipas rubrikës, Bashkia Tiranë ka konstatuar se, problematikat e vendqëndrimit abuziv dhe të paligjshëm të familjeve Rome janë të shumta, ndaj edhe ka vendosur që t'i largojë ato.

Në këto rrethana, Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Për shkak të emergjencës që paraqiste trajtimi i kësaj çështjeje, kemi kërkuar paraprakisht shpjegime nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur masat që ishin marrë nga ky institucion për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Paraprakisht kemi kërkuar të vihem në dijeni të faktit nëse Bashkia Tiranë kishte kryer një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare dhe trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu, kemi kërkuar informacion edhe mbi mënyrën se si ishte menduar dhe se, si do të zgjidhej problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na vënë në dispozicion një

kopje të njoftimit zyrtar që iu ishte komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku ato banonin, brenda afatit të shpallur 10 ditor.

Paralelisht, nga ana e përfaqësuesve të institucionit janë marrë kontakte në terren me familjet Rome/Egjiptiane, të vendosura në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, si dhe me organizata joqeveritare, apo me aktivistë Romë, që ushtrojnë aktivitet në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian në Shqipëri.

Nga të dhënat paraprake të marra në terren na ka rezultuar se, ishin rreth 50 familje Rome/Egjiptiane të vendosura në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, që banonin afërsisht në po të njëjtin numër barakash. Ky komunitet përbëhej nga rreth 200 individë, mes të cilëve gra, fëmijë, pleq, të cilët kishin një periudhë prej rreth 5 vitesh që banonin në barakat që kishin ndërtuar vetë. Pavarësisht njoftimit që kishkte dalë në media nga ana e Bashkisë Tiranë për zhvendosjen e tyre, banorët e këtij komuniteti na janë shprehur se nuk kanë patur asnjëherë njoftim zyrtar mbi këtë zhvillim të papritur për ta. Sipas tyre kontakti direkt i përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë, me banorët e komunitetit kishte filluar vetëm ditën e dielë, datë 04.10.2015 kur edhe ata kishin shkuar në këtë zonë dhe kishin filluar të merrnin të dhëna për familjet që ishin vendosur aty. Sipas deklarimeve të vetë komunitetit familjet e vendosura në këtë zonë ishin të ardhur kryesisht nga qytetet e Elbasanit, Beratit, por kishte edhe familje të cilat ishin vendosur aty pas shpërnguljes me forcë të ndodhur para disa vitesh nga zona e ish Stacionit të Trenit në Tiranë, apo edhe nga zona e “Pallatit me shigjeta”, në rrugën e Kavajës, në Tiranë.

Zhvendosja e tyre nga qytetet e tjera të vendit, apo të zonave të tjera të Tiranës sipas tyre kishte ndodhur për shkak të pamundësisë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe të një jetese më të mirë për këto familje. Aktiviteti kryesor me të cilin merreshin pjestarët e tyre të angazhuar me punë ishte mbledhja e bidonave plastikë, apo e kanaçeve në vendet e hedhjes së mbeturinave, për t'i shitur më pas në pikat përkatëse të grumbullimit të tyre.

Për shkak të shpejtësisë së ndodhjes së ngjarjeve dhe trajtimit faktik që Bashkia Tiranë po i bënte kësaj çështjeje,⁶ nga ana e Avokatit të Popullit u konsiderua e nevojshme një ndërhyrje e domosdoshme dhe urgjente me anë të një rekomandimi drejtuar Bashkisë Tiranë.

Paraprakisht evidentojmë faktin se, pavarësisht përpjekjeve tona institucionale për sqarimin e kësaj gjendjeje dhe marrjes së një informacioni të nevojshëm nga ana e Bashkisë Tiranë, për trajtimin e saj, nuk kemi patur një përgjigje zyrtare dhe nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument zyrtar nga Bashkia e Tiranës, deri në momentin e dërgimit të këtij rekomandimi.

Për të kuptuar gjendjen e krijuar, kemi referuar në këtë rekomandim, pikërisht ato parime dhe standarde ndërkombëtare mbi bazën e të cilave duhej të trajtohej kjo çështje në vazhdim.

Sipas rekomandimeve të OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jursiprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti ka detyrim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit të titullit të pronësisë. Pra, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore kundër dëbimeve të detyruara,

⁶ Në datë 07.10.2015, në shkelje të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë, u ushtrua presion për zhvendosjen e këtyre familjeve, nëpërmjet prezencës së një numri të madh punonjësish të Policisë Bashkiake, Tiranë, në zonën ku ndodhet ky komunitet.

ngacmimeve dhe kërcënimeve të tjera dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Janë disa parimet themelore që duhet të reflektohen në masat e domosdoshme që ndërmerren në proceset (procedurat) e dëbimit me forcë dhe më konkretisht:

- mosdiskriminimi para ligjit,
- detyrimi i përmbushjes progresive të detyrimit për strehim nga ana e shtetit, duke përdorur burimet maksimale në dispozicion, përpara se të kryhet dëbimi dhe prishja e banesës,
- kërkitimi dhe pranimiti i ndihmës ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë ose OJF,
- dhënia e prioritetit individëve më të rrezikuar dhe më të marginalizuar,
- krijimi i aksesit të plotë dhe në kohë të përshtatshme për informacion,
- pjesëmarrja efektive e komunitetit në bisedime dhe në proceset vendimmarrëse,
- llogaridhënia e autoriteteve përgjegjëse.

Në Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 4, për të drejtën për një strehim të përshtatshëm, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përcakton se e drejta për strehim nuk duhet të barazohet me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet pare si një e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. Në vazhdim ky Komitet ka përcaktuar se e drejta për strehim është një e drejtë e shumëanshme, që përbëhet nga shtatë aspekte, të cilat duhen përmbushur në mënyrë që të zbatohet plotësisht:

1. Siguria ligjore e posedimit/zotërimit,
2. Mundësia (shërbimeve, materialeve, dhe infrastrukturës),
3. Përballueshmëria,
4. Jetueshmëria,
5. Aksesueshmëria
6. Vendndodhja (e cila duhet të lejojë akses në tregun e punës, shëndetësi, arsim, kujdes për fëmijët dhe lehtësira të tjera sociale),
7. Përshtatshmëri kulturore.

Në çdo rast duhet theksuar se të gjitha parimet e parashikuara në këtë fushë, janë të reflektuara gjithashtu edhe në Rekomandimin e Komitetit të Këshillit të Europës, Rec (2005) 4, "Për përmirësimin e kushteve të strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Europë".⁷

Bazuar në këto akte të rëndësishme ndërkombëtare dhe në Komentin e Përgjithshëm nr.7 të Komitetit, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara për strehimin ka publikuar një numër udhëzimesh të detajuara, të njohura si Parimet dhe Udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe *Udhëzimet për lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen*. Këto parime dhe udhëzime bëjnë më të qarta detyrimet e shtetit në rastet e lirit me forcë të banesave.

Masat që jepen në këto parime dhe udhëzime kanë si qëllim që të ofrojnë orientime të qarta për zyrtarët dhe politikëbërësit për procedurat dhe masat që duhen marrë, për të dhënë sigurinë se lirimi i banesës është bërë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Sipas tyre, lirimi i banesës në kushtet e dëbimit me forcë kalon në tre faza, si vijon:

⁷ Website: wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=825545

- a) **Përpara lirit të banesës:** Bazuar në parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, lirimi i banesës duhet të konsiderohet si mjeti i fundit dhe pasi janë shqyrtuar të gjitha alternativat. Pra autoritetet publike, kanë barrën për të provuar se, dëbimi është i pashmangshëm për interesa publike. Duhet zhvilluar konsultime të vazhdueshme ku të ftohen të marrin pjesë të gjithë personat e prekur, ndërkohë që autoritetet nxisin pjesmarrjen e grave. Me qëllim që konsultimet të jenë efektive, autoritetet duhet t'u ofrojnë atyre që preken të gjithë informacionin e nevojshëm, që lidhet me arsyet për lirin e banesës, oraret e punës që do të kryhet, si dhe dhënien e kohës së nevojshme atyre që preken dhe avokatëve të tyre për të dhënë alternativat, komentet, sugjerimet, për planet e autoriteteve. Rezultati më ideal i këtyre përpjekjeve do të ishte përfundimi i një marrëveshjeje mes autoriteteve shtetërore dhe personave që do të lirtojnë banesën, ku rregullohen të gjitha aspektet e lirit të banesës dhe ofrohen alternativa për strehim.

Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantojnë se grupeve vullnetare si Romëve/Udhëtarëve u duhet ofruar mundësi të përshtatshme për të rregulluar strehimin e tyre dhe mosmarrja në konsideratë e nivelit të tyre të mohimit përgjatë viteve ku hartohen kërkesat e nevojshme për rregullimin e strehimit, mund të çojë në diksriminim të tërthortë.

Kjo është e rëndësishme jo vetëm për t'ju dhënë strehim atyre, por edhe për t'i ofruar sigurinë ligjore shtesë, për sa kohë që shtëpitë e paligjshme janë më shumë subjekt i prishjeve.⁸

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, thekson se prishja e shtëpive të paligjshme dhe krijimi i qytetit të barakave mund të jetë rezultat i mungesës së politikave efektive të strehimit. Për pasojë është e papranueshme, për të mos thënë e padrejtë, që të penalizosh ata njerëz që nuk kanë asnjë mbështetje nga shteti dhe që janë munduar të rregullojnë problemet e tyre të strehimit me të gjitha mënyrat që ata mundin, duke ushtruar të drejtën e "vetë-ndihmës".

Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj njeh gjykime të tilla si: Yordanova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, apo Liliana Assenova Naidenova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, ku theksohet se shkelje e të drejtave të njeriut konsiderohet në këto raste mungesa e ofrimit të çdo forme alternative të strehimit për Romët dhe familjet e tyre gjatë kohës që u lejua dëbimi, si dhe për faktin se autoritetet kishin lejuar Romët të jetonin atje për shumë vite dhe nuk mund t'i urdhëronin papritur që të largoheshin dhe të ndërprisnin jetën e tyre familjare dhe komunitare që kishin zhvilluar gjatë viteve.

- b) **Gjatë lirit të banesës:** Theksohet se kjo ndodh kur lirimi i banesës është i pashmangshëm dhe ai nuk mund të kryhet kur është mot i keq, gjatë festimeve zyrtare, gjatë natës, ose kur banuesit nuk ndodhen aty. Përdormi i forcës duhet të ndodhë plotësisht në përputhje me parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, për përdorimin e forcës.

- c) **Pas lirit të banesës:** Lirimi i banesës i pashoqëruar me ofrimin e alternativave të strehimit mund të konsiderohet në përputhje me të

⁸ Ankim kolektiv nr.31/2005, Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve kundër Bullgarisë, vendim themeli miratuar në 18 Tetor 2006.

drejtën ndërkombëtare vetëm në raste shumë përjashtimore. Në çdo rrethanë tjetër, autoritetet duhet të sigurojnë se ato që janë nxjerrë jashtë, kanë akses ndër të tjera në strehime dhe shtëpi, si dhe në shërbimet shëndetësore, ato të edukimit etj, dhe se lirimi me forcë nuk duhet t'i kthejë ata në të pastrehë. Për më tepër, autoritetet nuk duhet të injorojnë asnjëherë aspektin gjinor dhe duhet gjithmonë të përpiqen që të nxisin pjesëmarrjen e grave në të gjitha procedurat e nevojshme. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mirëqënies së grave dhe fëmijëve. Autoritetet duhet të monitorojnë dhe ndjekin kushtet sociale dhe shëndetësore të atyre që shpërngulen, veçanërisht në rastet e shpërnguljes së të gjithë komunitetit.

Por çfarë ka ndodhur realisht me situatën e krijuar për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës?

Avokati i Popullit, në rekomandimin e tij (*shih Aneks 1*), ka konstatuar se:

1. Zhvendosja e komunitetit rom/egjiptian, po kryhej pa patur një akt zyrtar administrativ bazë, produkt i një procedimi normal administrativ për organet e administratës publike, ku përfshihej edhe Bashkia Tiranë. Kjo mungesë shprehjeje e vullnetit të Bashkisë Tiranë, përmes aktit administrativ përkatës krijonte probleme serioze me shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj pjestarëve të komunitetit rom/egjiptian, në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës. Po kështu, kjo mënyrë informale veprimi ju hiqte të drejtën atyre të kundërshtonin këtë akt zyrtar, në rrugë administrative, apo edhe gjyqësore.
2. Zhvendosja po kryhej në mungesë të një komunikimi dhe konsultimi të domosdoshëm, midis Bashkisë Tiranë dhe komunitetit të prekur, lidhur me përcaktimin e zgjidhjeve oportune. Në këto kushte mungonte informacioni i plotë mbi çfarë i priste këta qytetarë dhe kjo situatë rrezikonte të rëndonte më tej gjendjen e tyre të vështirë, duke krijuar një tjetër problem edhe më të mprehtë social.
3. Sikurse evidentohet nga mënyra e trajtimit të deritatëhershëm, por edhe nga informacioni që kishim deri në atë kohë, Bashkia Tiranë nuk dispononte një plan të mirëmenduar, të mbështetur në një njohje të plotë të tipologjisë së komunitetit, gjendjes të secilës prej familjeve, qoftë në aspektin e aksesit për një strehë të sigurt, aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, gjendjen e tyre ekonomike dhe të pasojave që do të vuante secila prej tyre, në rast zhvendosje, nga zona e Liqenit Artificial të Tiranës.
4. Në këtë rast nuk bëhej fjalë vetëm për të drejtën për strehim pasi zhvendosja e pastudjuar dhe në mungesë të konsultimit me komunitetin në fjalë, mund të cënonte dhe të drejtën e tyre për jetën familjare, si dhe të drejtën e tyre për jetën.
5. Kjo situatë po përcillej, si nga ana e Bashkisë Tiranë, ashtu edhe nga ana e disa mediave, me një gjuhë e cila krijonte premisë për nxitjen e urrejtjes dhe përforconte stereotipe krejtësisht të dëmshme për një shoqëri demokratike, ose të cilat ushqenin qëndrime diskriminuese kundrejt këtij komuniteti.

6. Zhvendosja, apo dëbimi i paralajmëruar me forcë i këtyre familjeve është theksuar se përbënte një ngjarje të përsëritur për komunitetet e përkatësisë Rome, apo edhe Egjiptiane, të vendosura në zona periferike, në qytetet më të mëdha të vendit. Shumica e këtyre ngjarjeve në vlerësimin e Avokatit të Popullit është theksuar se ishin zhvilluar në shkelje të të drejtave të komuniteteve përkatëse.
7. Ne kemi nënvizuar faktin dhe kemi shprehur gjykimin tonë se, zhvendosja (dëbimi me forcë) i këtij komuniteti, nuk po kryhej në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme; nuk po respektoheshin detyrimet e parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndërhyrja më e fundit e punonjësve të Policisë Bashkiake, të Bashkisë Tiranë, paraditen e datës 07.10.2015, të cilët kanë shkuar në zonën ku ndodheshin barakat e këtij komuniteti, duke bërë presion për largimin e familjeve rome/egjiptiane, vërtetonte edhe një herë faktin se, trajtimi i kësaj çështjeje nuk po respektonte asnjë nga parimet dhe standardet bazë ndërkombëtare, të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë.

Si një çështje me përmasa delikate të aspektit juridik dhe social, zhvendosja e komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, të Tiranës, duhet të trajtohej duke respektuar të drejtat e këtij komuniteti dhe duke parashtruar zgjidhje konkrete, efektive, të qëndrueshme dhe afatgjata, me qëllim garantimin e një jetesë më të mirë dhe jo përkeqësimit të saj.

Edhe alternativa e ofruar nga ana e Bashkisë Tiranë për strehimin e disa prej këtyre familjeve në Qendrën e Emergjencave Civile, në Tufinë, Tiranë, nuk zgjidhte në thelb problematikën e familjeve të komunitetit në fjalë. Kjo ishte një zgjidhje e përciptë, e përkohëshme, ndërkohë që institucioni i Avokatit të Popullit prej kohësh apelonte dhe rekomandonte me forcë për zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që përmirësojnë realisht kushtet e jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

Çështja në fjalë bëhej edhe më sensitive, pasi kishim të bënim me trajtimin e çështjes së strehimit të familjeve të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian, si dhe të respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, mungesa e kushteve minimale të jetesës së anëtarëve të këtij minoriteti është një problem serioz, jo vetëm për ata vetë si individë, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që ky minoritet të ndihet i diskriminuar, i pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Kjo praktikë trajtimi e çështjes në gjykimin tonë është theksuar se, u hiqte mundësinë familjeve Rome që të kërkonin nga një gjykatë e paanshme që të vlerësohej rast pas rasti, nëse ishim përpara kufizimit të së drejtës për strehim nga akti i administratës publike, duke marrë parasysh të gjitha detyrimet që shtetit i lindin në bazë të kërkesave të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).⁹

⁹ Nëse gjykatat nuk kanë mundësinë që të marrin në konsideratë faktin që paditësit rrezikojnë të mbeten të pastrehë dhe për këtë arsye ta konsiderojë këtë rrezik iminent, të rëndë dhe të pariparueshëm, në rastet

Sa më sipër, i kemi rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Tiranë:

1. Analizimin e kujdesshëm dhe të shpejtë të gjendjes së krijuar dhe pezullimin e veprimeve të mëtejshme nga ana e Bashkisë Tiranë, sa i takon çështjes së zhvendosjes së komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial të Tiranës.

2. Zgjidhjen e situatës në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, me qëllim që këtij komuniteti t'i ofrohen zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që synojnë dukshëm përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në vend.

Ky rekomandim është dërguar me shkresën tonë nr. K1/I118-4 datë 08.10.2015. Ende sot e kësaj dite nuk ka një përgjigje zyrtare nga ana e Bashkisë Tiranë, ku të shprehet qëndrimi i saj ndaj këtij rekomandimi.

- **Deklaratë për median** (*shih Aneks 2*).

Në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, në datën 8 Tetor 2015 është organizuar një takim me disa prej shoqatave dhe qendrave të shoqërisë civile, me kontribut të spikatur në mbrojtje të të drejtave të njeriut, ku është diskutuar mbi gjendjen e krijuar pas deklaratës së shpallur në media, për zhvendosjen e komunitetit rom/egjiptian në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, nga ana e Bashkisë Tiranë dhe për gjendjen konkrete që vërehej çdo ditë pranë këtij komuniteti.

Pas këtij takimi, nga ana e Avokatit të Popullit dhe pjesëmarrësve të tjerë në takim u dakordësua dalja me një deklaratë të përbashkët për median, (e publikuar në datë 8.10.2015), ku shprehej se:

“Avokati i Popullit, në vijim të përpjekjeve për të shmangur situatën e dëbimit me forcë të komunitetit Romë/Egjiptianë nga Parku i Liqenit dhe në funksion të gjetjes së një zgjidhje të qëndrueshme, dinjitoze dhe afatgjatë për këta qytetarë, zhvilloi dhe një takim me përfaqësues të Bashkisë Tiranë. Në këtë takim ishin të pranishëm edhe përfaqësues të shoqërisë civile, si pjesë e veprimit të përbashkët institucional në respektimin dhe garantimin e të drejtave të këtij komuniteti.

Gjatë takimit, veç të tjerave, përfaqësuesve të Avokatit të Popullit ju është bërë me dije nga ana e Bashkisë Tiranë ekzistenca e një plan-veprimi për zhvendosjen e komunitetit Romë/Egjiptianë pranë Liqenit Artificial, por nuk ju është vënë në dispozicion. Gjejmë rastin të falënderojmë Bashkinë e Tiranës për gadishmërinë e treguar gjatë parashtrimit të shqetësimit tonë. Vlerësojmë kontributin dhe mbështetjen e shoqërisë civile në këtë përpjekje për të ndihmuar këta qytetarë në kushte tejet të vështira jetese, si dhe një falënderim të veçantë për median dhe rolin e saj në pasqyrimin e informacioneve mbi këtë situatë.

kur individët mund të jenë në kushtet e pamundësisë financiare për të siguruar banesë alternative (me qira), atëherë në mënyrë efektive kemi shkeljen e nenit 8, të KEDNJ, përmes një ndërhyrjeje joproporcionale. Më i rëndë paraqitet rasti i grupeve vulnerabel, siç edhe është komuniteti rom dhe ai egjiptian.

Bazuar në parimet dhe standardet ndërkombëtare për trajtimin e rasteve të zhvendosjeve apo të dëbimeve me dhunë, si një situatë e mundshme edhe për këtë komunitet, Avokati i Popullit dëshiron të theksojë qëndrimin e tij të vendosur, i cili konsiston në:

1. Ofrimin dhe gjetjen e një zgjidhje të qëndrueshme, afatgjatë dhe të pranueshme nga këta qytetarë
2. Të mos kryhet asnjë zhvendosje pa garantuar më parë një zgjidhje të qëndrueshme, dinjitoze, të dokumentuar zyrtarisht dhe të verifikueshme fizikisht.
3. Çdo veprim nga ana e autoriteteve vendore duhet të ndërmerret në bashkëpunim dhe me pëlqimin e plotë të anëtarëve të komunitetit romë/egjiptianë në parkun e liqenit.
4. Të shmangët situata e dëbimit me forcë dhe ushtrimit të dhunës ndaj këtyre qytetarëve, në të kundërt do të përballemi me një situatë paligjshmërie, ku cenohen rëndë liritë dhe të drejtat e individit.

Avokati i Popullit i mbetet koherent qëndrimin se çdo opsion tjetër i ofruar jashtë këtyre parimeve dhe standardeve ndërkombëtare, nuk mund të konsiderohet si një zgjidhje afatgjatë, e qëndrueshme dhe e përshtatshme për këtë komunitet.

Zhvendosja e familjeve romë/egjiptiane nga parku i liqenit, e cila nuk respekton parimet e sipërcituara dhe që përjashton këtë komunitet nga komunikimi, informimi dhe pranimi i zgjidhjes së ofruar me marrëveshje nga vetë anëtarët e këtij komuniteti përbën thjesht dhe vetëm një situatë dëbimi me forcë, që shkel rëndë të drejtat e tyre”.

4. Zhvillime pas paraqitjes së rekomandimit të Avokatit të Popullit, në terren. Ankesat e banorëve të komunitetit rom.

Pas fillimit me iniciativë të hetimit të çështjes së zhvendosjes së banorëve të komunitetit rom/egjiptian nga zona e Liqenit Artificial në Tiranë, Avokati i Popullit ka kontaktuar drejtëpërsëdrejti me banorët e këtij komuniteti të vendosur në këtë zonë dhe ka administruar në datë 06.10.2015, ankesa individuale, për problemin dhe shqetësimin serioz të shprehur konkretisht prej tyre lidhur me zhvendosjen, mungesën e informacionit për veprimet që po ndërmerreshin nga ana e Bashkisë Tiranë, si edhe alternativat që do t'i ofroheshin atyre, pas zhvendosjes së pritshme.

Nga njoftimet paraprake ka rezultuar se, në këtë zonë ishin vendosur rreth 50 familje romë/egjiptiane, me një numër të përafërt prej 200 banorësh. Këta banorë kanë dëshmuar se ishin vendosur prej më shumë se 5 vitesh në këtë zonë dhe se nuk kishin patur paraprakisht asnjë problem me banorët e zonës përreth, apo organet e administratës publike. Ata janë shprehur se kanë ndërtuar jetesën e tyre mbi bazën e vetëpunësimit dhe të sigurimit të burimeve të jetesës përmes mbledhjes dhe tregimit të materialeve të riciklueshme.

Problematike në këtë situatë ka qënë situata e paqartë e pronësisë mbi truallin ku ishte vendosur ky komunitet, pasi Bashkia Tiranë pretendonte se kishim të bënim me truall shtetëror, ndërkohë që vet komuniteti, persona pretendentë si pronarë privatë, apo edhe një verifikim i shpejtë nga ana e vet zyrës sonë në

Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, nxirrte se në zonë kishte edhe ekzistencë të pronësisë private.

Ndërkohë, banorët e komunitetit në fjalë kishin krijuar edhe një marrëdhënie me një person pretendent si pronar privat i truallit ku ishin vendosur, duke i dhënë atij një pagesë simbolike qiraje, për shkak të përdorimit të kësaj prone nga ana e tyre. Theksojmë faktin se, banorët e parë të komunitet rom/egjiptian ishin vendosur në këtë truall me miratimin e këtij personi, pavarësisht nga fakti se pas disa vitesh numri i familjeve të vendosura aty ishte shtuar së tepërmi. Bazuar mbi këtë zhvillim, ky person pretendet si pronar privat i truallit, para disa vitesh kishte kërkuar nga administrata e Bashkisë Tiranë që të merrete masa për largimin e këtyre familjeve nga trualli i tij privat, ku ata fillimisht ishin vendosur me miratimin e tij. Kërkesat e tij janë refuzuar nga ish kryeinspektori i Policisë Bashkiake, të Tiranës, ndërkohë që në rastin që po analizohet në këtë raport ishin punonjësit e Policisë Bashkiake, ata që po tregoheshin aktiv në lirin e këtij trualli.

Titulli i pronësisë të truallit ku ishte vendosur ky komunitet është hetuar paraprakisht dhe konfirmuar nga ekspertë të institucionit të Avokatit të Popullit, pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, duke dokumentuar për këtë qëllim një fragment të hartës treguese të regjistrimit, për pasurinë e paluajtshme, ku edhe ishin vendosur banorët e komunitetit rom/egjiptian (*shih Aneks 3*). Në këtë hartë pasqyrohen njëkohësisht edhe kufitarët e kësaj pasurie, që gjithashtu janë subjekte private.

Për përcaktimin e saktë të statusit të pronësisë të sipërfaqes së tokës, si dhe sipërfaqen konkrete të tokës, ku ishte vendosur komuniteti Rom/Egjiptian, nga ana e institucionit është marrë një ekspert i pavarur i fushës, të cilit i janë lënë dy detyra për t'i sqaruar me akin përkatës të ekspertimit teknik:

1. Azhurnimi faktik i ish vendqëndrimit të komunitetit Rom/Egjiptian, në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë.
2. Saktësimi i njollës së këtij ish vendqëndrimi në hartën kadastrale të zonës, Liqeni Artificial, Tiranë.

Në aktin e ekspertimit teknik, të datës 11.01.2016 (*shih Aneks 4*), eksperti i pavarur topograf i shoqërisë "Taulant" shpk, ka paraqitur një konkluzionet e tij pas ekspertimit sipas të cilave:

- Sipërfaqja e përdorur si vendqëndrim nga komuniteti Rom/Egjiptian është e ndarë në dy parcela pasi në mes të tyre ekziston një kanal që e ndan këtë vendqëndrim në dy,
- Sipërfaqet e përdorura si vendqëndrim nga komuniteti Rom/Egjiptian janë S1=6000m² dhe S2=11300m².

Ndërkohë sipas planit të rilevimit bashkëngjitur këtij akt ekspertimi, si dhe referuar hartës treguese të regjistrimit të marrë në ZVRPP, Tiranë, për zonën kadastrale 8280, na rezulton se:

Sipërfaqja S1, e identifikuar në planin e rilevimit bazuar në hartën ZK 8280 TR, përfshin në një masë të madhe të saj pronësi private, si dhe në një pjesë të vogël pronësi shtetërore.

Pronësia private në të cilën rezulton të jetë vendosur në sipërfaqen S1, komuniteti Rom/Egjiptian, prek pronësitë me nr.1/405; 1/388; 1/391; 1/392; 1/387; 1/116 dhe 1/115. Ndërsa pjesa tjetër është pronësi shtetërore.

Sipërfaqja S2, e identifikuar në planin e rievimit bazuar në hartën ZK 8280 TR, përfshin në një masë të madhe të saj pronësi shtetërore, si dhe në pjesën tjetër, pronësi private.

Pronësia private në të cilën rezulton të jetë vendosur në sipërfaqen S2, komuniteti Rom/Egjiptian, prek pronësitë me nr.1/410; 1/126 dhe 1/73. Ndërsa pjesa tjetër është pronësi shtetërore.

Në konkluzion ajo që na rezulton sa i takon statusit të pronësisë të sipërfaqes së tokës ku ishte vendosur komuniteti Rom/Egjiptian është se, zhvendosja e kryer nga ana e Bashkisë Tiranë, ka ndodhur për një sipërfaqe toke e cila administrohet nga ana e këtij institucioni të qeverisjes vendore, si dhe në një masë të dallueshme edhe për një sipërfaqe toke eventualisht në pronësi private.

Specifikisht, sa i takon sipërfaqes së tokës në pronësi private ku ishte vendosur komuniteti Rom/Egjiptian, konstatohet se nga ana e Bashkisë Tiranë me masat e marra për zhvendosjen e këtij komuniteti është vepruar në mënyrë flagrante në kundërshtim me ligjin. Sipas legjisllacionit në fuqi, konkretisht nenit 296 të Kodit Civil, parashikohet e drejta e çdo subjekti të qarkullimit civil, për të paraqitur një padi në gjykatë për të kërkuar lirim e dorëzimin e truallit, apo pasurisë që mbahet në mënyrë të paligjshme nga një person, apo subjekt tjetër. Në vijim të procedurave për përmbushjen apo mbrojtjen e të drejtës së tij të ligjshme, subjekti kërkon edhe ndjekjen e procedurave të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, potencialisht në favorin e tij, procedura të cilat mund të mbështeten edhe nga forcat e policisë së shtetit. Veprimet apo procedurat që ndiqen për lirim e një truall pa një vendim gjyqësor, janë totalisht antiligjore dhe në kundërshtim me frymën e ndërtimit dhe konsolidimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri. Kjo bazë rregullatore ligjore, qartëson faktin se Bashkia Tiranë ka kryer së paku për këtë pjesë të sipërfaqes së tokës ku ishte vendosur komuniteti Rom/Egjiptian, veprime krejtësisht në tejkalim të juridiksionit dhe kompetencave të përcaktuara me ligj.

Duke analizuar edhe elementët e tjerë të shkeljeve ligjore të konstatuara në trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e Bashkisë Tiranë, theksojmë se ky fakt rëndon pozitën e institucionit të Bashkisë Tiranë, në ndërhyrjen e kryer për zhvendosjen e komunitetit Rom/Egjiptian, në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë.

Në këtë kuadër theksojmë faktin se, në monitorimin e situatës në terren me datë 14.10.2015, ekspertë të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë një komunikimi me median mbi situatën në këtë komunitet kanë konstatuar zhvillimin e debateve dhe përplasjeve verbale, mes pronarëve privatë të truallit me punonjës të Bashkisë Tiranë. Pronarët e truallit kanë kërkuar sqarime dhe informacione në këtë rast, mbi aktet administrative që legjitimonin ndërhyrjen e Bashkisë Tiranë, në funksion të lirit të truallit të tyre privat. Një pjesë e truallit ku ishte vendosur komuniteti rom/egjiptian pas largimit të tyre është mbjellë me pemë në ditët në vijim, ndërkohë që është konstatuar se nuk është kryer asnjë punim tjetër mbi sipërfaqen tjetër të truallit (në pronësi të shtetasit F.B), mbi të cilin ishin vendosur numri më i madh i familjeve të zhvendosura.

Ky ambiguitet pretendimi mbi pronësinë e truallit ku ishin vendosur familjet e komunitetit rom/egjiptian në zonën e Liqenit Artificial Tiranë, vë në dyshim edhe kompetencën ligjore mbi trajtimin e rastit dhe të procedurave të ndjekura, përfshirë këtu edhe qëndrimin dhe deklaratat publike të Bashkisë Tiranë, mbi

nevojën dhe urgjencën e lirit dhe pastrimit të hapësirave publike në këtë çështje.

Ndërkohë, në datë 27.10.2015, në institucionin e Avokatit të Popullit janë paraqitur përfaqësuesit e 9 familjeve romë, pjesë e komunitetit të sipërcituar, të cilat kanë ngritur shqetësimin e tyre se, Bashkia Tiranë nuk kishte marrë asnjë masë për strehimin e tyre, sipas varianteve të propozuara përpara zhvendosjes nga zona ku edhe kishin banuar më parë. Konkretisht kanë paraqitur ankesa, këta shtetas:

- Xh.K (me dy anëtarë familjeje)
- P. N (me gjashtë anëtarë familjeje)
- M. Z (me pesë anëtarë familjeje)
- M. N (me tre anëtarë familjeje)
- K. Z (me shtatë anëtarë familjeje)
- H. Z (me gjashtë anëtarë familjeje)
- G. Z (me katër anëtarë familjeje)
- E. N (me katër anëtarë familjeje)
- B. Z (me katër anëtarë familjeje).

Të gjitha këta shtetas rezultojnë të regjistruar me vendbanim, në regjistrin e gjendjes civile të Bashkisë Elbasan dhe në momentin e depozitimit të ankesave ishin vendosur në një truall privat, në afërsi të zonës ku edhe ishte vendosur para zhvendosjes komuniteti rom/egjiptian, në Liqenin Artificial, në Tiranë. Paraprakisht duhet nënvizuar fakti se ata kishin qënë pjesë e komunitetit rom/egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, por më pas ishin zhvendosur, për t'u kthyer sërish aty.

Konkretisht, shtetasi (ankuesi) H.Z, ka dëshmuar para ekspertëve të institucionit të Avokatit të Popullit se kishte rreth dy javë që i kishin dërguar me makinat e Bashkisë Tiranë, për në qytetin e Elbasanit, në dalje të qytetit tek Lagjia "5 Maji". Aty ka qëndruar rreth një javë në qiell të hapur. Më datë 21.10.2015 ata janë kthyer sërish në qytetin e Tiranës, me shpenzimet e tyre dhe janë vendosur sërish në Sauk. Pas rikthimit nuk kanë konstatuar asnjë veprim nga Bashkia Tiranë, lidhur me strehimin e tyre, apo ofrimin e mundësive alternative për strehim. Përkundrazi, ata kanë patur probleme ditën e parë të rikthimit dhe të vendosjes së tyre në një truall tjetër privat, në afërsi të po asaj zone ku edhe kishin qëndruar më parë, me punonjësit e Policisë Bashkiake, Tiranë dhe të Policisë së Shtetit, të cilët janë konfliktuar ndërkohë edhe me pronarët e truallit, për të mos lejuar vendosjen e familjeve romë, aty.

Ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit kanë monitoruar dhe inspektuar në vazhdimësi situatën dhe gjendjen e banorëve të komunitetit rom. Në këtë kuadër janë dokumentuar edhe dëshmitë e tyre për kërcënime dhe presione nga ana e punonjësve të Bashkisë Tiranë, kryesisht të policisë bashkiake. Kështu sipas dëshmisë të shtetasis E.S, dokumentuar më datë 13.10.2015, rezulton se më datë 03.10.2015, rreth orës 09:00-10:00, pranë zonës ku ishte vendosur komuniteti rom/egjiptian, janë pozicionuar një furgon dhe dy makina të vogla të Policisë Bashkiake, me rreth 10 punonjës policie, të cilët verbalisht u kanë lënë afat familjeve të komunitetit për t'u larguar deri të nesërmen, përndryshe do t'i largonin me dhunë.

Kjo ngjarje u është komunikuar edhe ekspertëve të Avokatit të Popullit që janë nisur direkt për në vendngjarje menjëherë pas marrjes së njoftimit nga banorët

dhe aktivistët rom në terren. Gjatë komunikimit me një punonjës të Bashkisë Tiranë, i cili është prezantuar si Drejtori i Strehimit në këtë bashki, z. Elton Kacidhja, ngjarja është cilësuar si aksident dhe se nuk do të ndodhte më.

Ndërkohë ka rezultuar se, ky shtetas nuk kishte marrë ende zyrtarisht detyrën e mësipërme dhe nuk mund të ushtronte ligjërisht ato kompetenca funksionale, sipas pozicionit zyrtar me të cilin ai u prezantua tek ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit.

Duhet përmendur fakti se, shumë prej banorëve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, nuk kanë pranuar akomodimin e tyre në Qendrën Kombëtare të Emergjencave Civile në Tufinë, pasi kanë pretenduar se kishin probleme dhe konflikte personale me personat dhe familjet tashmë të akomoduara atje.

5.Korrespondenca me institucione të tjera të përfshira në çështje.

Pas fillimit të shqyrtimit të kësaj çështjeje me inisiativë, në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Avokati i Popullit, ka kërkuar me shkresën nr. K3/I118-2 datë 05.10.2015 (*shih Aneks 5*), dhënie shpjegimesh dhe dhënie kopjeje dokumentacioni zyrtar nga ana e Bashkisë Tiranë.

Shpjegimet e kërkuara lidhen me identifikimin e masave që ishin marrë nga Bashkia Tiranë, për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ekzistencës së një studimi paraprak të gjendjes së familjeve të komunitetit rom/egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim. Shpjegime janë kërkuar edhe lidhur planifikimin se si do të zgjidhej problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke kërkuar njëkohësisht edhe vënien në dispozicion të një kopjeje të njoftimit zyrtar, që iu ishte komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku ata banonin, brenda afatit 10 ditë të njoftuar në media. Bashkia Tiranë nuk ka kthyer përgjigje ndaj kësaj kërkesë të drejtuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, pavarësisht faktit se në kërkesën tonë theksohej urgjenca dhe nevoja e dërgimit në një kohë sa më të shpejtë.

Për shkak të situatës së tensionuar, të paqartë dhe pa perspektivë të komunitetit rom/egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, i jemi drejtuar me rekomandimin tonë të cituar më lart, dërguar me shkresën nr. K1/I18-4 datë 08.10.2015, Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak Tiranë, duke vënë në dijeni për këtë rekomandim edhe Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Ministrin e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Ministrin e Punëve të Brendshme, si dhe Ministren e Zhvillimit Urban.

Duke qenë se nuk kishte sërish asnjë reagim institucional dhe përgjigje zyrtare nga ana e Bashkisë Tiranë, institucioni i Avokatit të Popullit iu ridrejtua me shkresën me nr. K3/I118-5 datë 12.10.2015 këtij institucioni (*shih Aneks 5*), duke kërkuar në mënyrë të përsëritur shpjegime dhe informacion zyrtar, të cituar në kërkesat e shkresës sonë të mëparshme me nr. K3/I118-2 datë 05.10.2015.

Në përgjigje të këtyre shkresave tona, Bashkia Tiranë me shkresën e saj me nr. 14399/1 datë 16.10.2015 (*shih Aneks 5*), na ka vënë në dijeni mbi veprimet e saj të ndërmarra në kuadër të planit të masave për zhvillimin e një sistemi të kombinuar të mirëqënies sociale në nivel vendor, pjesë e të cilit ishte edhe sistemimi i familjeve që jetonin në kushte të papërshtatshme, në zonën e Parkut të Liqenit Artificial, të Tiranës. Bashkia Tiranë, në këtë përgjigje thekson se

mbështetur në një plan ndërhyrje të detajuar, procesi i ndërhyrjes kishte mundësuar dhe do të mundësonte në të ardhmen:

1. Vlerësimin social të fëmijëve dhe familjeve,
2. Hartimin e planeve individuale për çdo familje,
3. Zbatimin e planeve individuale të ndërhyrjes, referimit dhe ndjekjes,
4. Transferimin e familjeve nga vendbanimet aktuale në vendin e origjinës, apo vendbanimet alternative në Bashkinë Tiranë.

Siç rezultoi gjatë monitorimit në vazhdimësi të situatës së këtyre familjeve nga ana e ekspertëve të Avokatit të Popullit, asnjë nga këto masa të përshkruara në përgjigjen zyrtare të Bashkisë Tiranë nuk u përmbush dhe nuk u realizua përkundrejt çdo anëtarit të komunitetit përkatës rom/egjiptian.

Nga ana tjetër, Bashkia Tiranë theksonte se ishin vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me bashkitë reciproke, ku edhe familjet ishin të regjistruara dhe departamentet sociale në këto bashki ishin angazhuar të asistonin të gjitha procedurat, logjistikën dhe me financat e nevojshme përgjatë këtij procesi, në pritje të këtyre familjeve.

Rikthimi i shumë prej këtyre familjeve në Tiranë pas zhvendosjes nga zona e Liqenit Artificial, dëshmon qartë faktin se nga ana e bashkive pritëse nuk ka patur asnjë lehtësim për pritjen dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për strehim, të atyre familjeve që ishin zhvendosur nga zona e Liqenit Artificial, dhe dërguar në qytetet ku kishin banuar më parë.

Në këto kushte, duke u nisur nga ky qëndrim përgjithësues dhe i paqartë i Bashkisë Tiranë, që nuk i referohej aspak shqetësimeve dhe kërkesave të parashtruara nga ana jonë në rrugë institucionale, Avokati i Popullit i është drejtuar sërish me shkresën me nr. K3/I91-8 datë 29.10.2015 Bashkisë Tiranë (*shih Aneks 5*), duke kërkuar në mënyrë specifike informacion lidhur me:

1. Studimin paraprak që i kishte paraprirë këtij procesi dhe që lidhej me përcaktimin e gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim nga ana e Bashkisë Tiranë, që ishte kryer për këtë rast. Një kopje e këtij dokumenti zyrtar kemi kërkuar të na dërgohej bashkëngjitur përgjigjes së pritshme të bashkisë.
2. Kopjen e akteve zyrtare mbi bazën e të cilave ishte filluar dhe kishte përfunduar procesi i zhvendosjes së familjeve rom/egjiptiane, nga zona e Liqenit Artificial, Tiranë. Megjithëse nga ana jonë në shkresat e mëparshme ishte kërkuar fillimisht, kopja e njoftimit zyrtar që iu ishte komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku banonin brenda afatit 10 ditor, përsëri kjo kopje dokumenti zyrtar nuk ishte dërguar nga ana e Bashkisë Tiranë.
3. Kopjen e marrëveshjeve apo shkresave të komunikimit zyrtar me Bashkitë Elbasan, Pogradec, Berat dhe Devoll, përse i takon transferimit të familjeve nga vendbanimet aktuale në vendin e origjinës, ku edhe parashikohen të gjitha masat respektive për çdo familje, sipas kriterëve të konfirmuara në shkresën e Bashkisë Tiranë.
4. Numrin dhe emrat e kryefamiljarëve të familjeve të mbetura, që nuk kishin ardhur nga bashki të tjera, për të cilat ishte kërkuar zyrtarisht mundësia për strehimin e tyre, në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, si dhe Strehimi në banesa private mbështetur në Programet e Strehimit të Bashkisë Tiranë, përkatësisht Bonusi i

Strehimit, ku pjesa më e madhe e qerasë do të subvencionohej nga buxheti i vet Bashkisë Tiranë. Ky informacion duhet të shoqërohej me kopje të dokumenteve zyrtare, që konfirmonin kërkesën për strehimin në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, si dhe procesin e vendimmarrjes për trajtim me strehim alternative, sipas Programeve të Strehimit të Bashkisë Tiranë, përkatësisht Bonusit të Strehimit, të këtyre familjeve.

Ende sot e kësaj ditë nuk ka përgjigje zyrtare nga ana e Bashkisë Tiranë, ndaj kësaj kërkesë tonës. Ky fakt, dëshmon mungesën e transparencës në veprimet e ndërmarra nga Bashkia Tiranë në situatën e krijuar me zhvendosjen e familjeve komunitetit rom/egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, por edhe mungesën dhe refuzimin për bashkëpunim me institucionin e pavarur, të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, Avokatin e Popullit.

- *Komunikimi zyrtar me Policinë Bashkiakë, Tiranë.*

Banorët e komunitetit rom/egjiptian, në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë janë ankuar vazhdimisht dhe kanë dëshmuar pranë ekspertëve të Avokatit të Popullit, për presionet dhe kërcënimet e ushtruara gjatë gjithë periudhës së zhvendosjes nga kjo zonë, prej punonjësve të Policisë Bashkiakë, Tiranë, (siç ishte rasti i cituar më sipër lidhur me praninë e një grupi të madh të këtyre punonjësve me datë 03.10.2015).

Pas zhvendosjes së komunitetit rom/egjiptian nga kjo zonë, drejt vendeve të tjera, apo qendrave të tjera banimit ku edhe kanë patur regjistrimin e tyre në gjendjen civile, na ka rezultuar se një pjesë e familjeve të zhvendosura rome janë rikthyer sërish në afërsi të zonës ku kanë jetuar. Kjo ka ndodhur pasi në qytetet ku ata janë kthyer, nuk kanë patur dhe nuk u janë siguruar kushtet minimale të jetesës dhe strehimit. Konkretisht rezultoi se gjashtë familje Rome u vendosën në një truall privat, në pronësi të shtetasve Brahja. Ndërkohë që pas inspektimit të kushteve të jetesës së këtyre familjeve nga ekspertë të Avokatit të Popullit, në datë 28.10.2015, anëtarët e këtyre familjeve janë shprehur se kanë patur presione dhe u është dhënë ultimatum nga ana e punonjësve të policisë bashkiakë për lirin e truallit privat, ku ishin vendosur me mirëkuptimin dhe miratimin e njërit prej bashkëpronarëve (shtetasit H. B).

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit i është drejtuar Kryeinspektorit të Policisë Bashkiakë Tiranë, me shkresën me nr. K3/I91-14 datë 29.10.2015 (*shih Aneks 6*), duke kërkuar konkretisht shpjegime dhe informacione lidhur me çështjet:

- a) nëse kishte patur verifikime nga punonjës të Policisë Bashkiakë Tiranë të situatës së familjeve rome të vendosura në një truall privat, në afërsi të kampit ku kishin jetuar më përpara;
- b) cilat ishin aktet dhe baza ligjore e verifikimit të kryer, si dhe e kërkesave për lirin e truallit;
- c) çdo informacion tjetër që kishte të bënte me çështjen, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura.

Presionet dhe kërcënimet e vazhdueshme të punonjësve të Policisë Bashkiakë u finalizuan mbrëmjen e datës 07.11.2015, kur familjet e mbetura dhe të strehuara në një godinë të braktisur private, u dëbuan dhe u shpërndanë gjetiu,

sipas mundësive të tyre. Çuditërisht në përgjigje të kërkesës sonë për shpjegime me anë të shkresës nr.16373/1 datë 24.12.2015, Kryeinspektori i Policisë Bashkiake ka konfirmuar shprehimisht se: "Policia Bashkiake nuk ka patur dijeni, si dhe nuk ka qënë pjesë e këtij Plani Veprimi, për të zhvendosur, pjesëtarët e komunitetit rom tek Liqeni, në vendet e tjera të origjinës si Elbasan, Berat, etj".

Avokati i Popullit në bashkëpunim me organizata të ndryshme të shoqërisë civile që veprojnë në mbrojtje të të drejtave të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian, e ka dokumentuar faktin e dëbimit të këtyre familjeve. Pavarësisht se ato ishin vendosur në një godinë të braktisur private, për t'u mbrojtur nga kushtet atmosferike, punonjësit e Bashkisë Tiranë kanë ndërhyrë për t'i dëbuar nga kjo ndërtesë.

Kështu rezulton se, në datë 07.11.2015, rreth orës 15:50, aktivistët e shoqërisë civile kanë shkuar në vend pas njoftimit që atyre u ishte bërë nga këto familje. Ata konstatuan se familjet rome jetonin në një ndërtesë, në ndërtim e sipër, në zonën mes rrugës automobilistike dhe Liqenit të Thatë, (pjesë e Liqenit Artificial, Tiranë). Familjet ishin vendosur në këtë ndërtesë, që prej 2 javësh. Në momentin kur kanë arritur aktivistët e shoqërisë civile në vendngjarje, kanë gjetur përfaqësues nga Policia Bashkiake, Tiranë, nga Policia e Shtetit dhe përfaqësues të Njësisë Administrative Farkë, të cilët ishin duke u konfliktuar me familjet rome. Nga kontakti fillestar që kanë marrë me punonjësin e Policisë Bashkiake, Tiranë, aktivistëve iu është komunikuar se për shkak të ankesave, familjet Rome do të duhet të largoheshin nga ndërtesa ku qëndronin.

Në vijim atyre ju është kërkuar baza ligjore dhe urdhëri konkret, mbi bazën e të cilit po kryheshin veprimet. Punonjësit e Policisë Bashkiake, Tiranë janë shprehur se, urdhëri atyre iu ishte dhënë në mënyrë verbale. Sipas asaj që ka deklaruar punonjësi përkatës i Policisë Bashkiake, Tiranë, nuk ishte pronari i ndërtesës ai që e kishte bërë ankesën. Më vonë kanë mbërritur në vendngjarje edhe punonjës të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Mjedisit, në Bashkinë Tiranë, si edhe një kamion që mendohej se do të përdorej për t'i zhvendosur familjet.

Pas disa situatash të tensionuara dhe të frikësuar kryesisht nga presioni i punonjësve të Policisë Bashkiake, Tiranë, familjarët filluan të mbledhin veshjet, sendet dhe disa orendi shtëpiake që ata kishin me vete, si dyshekë etj. dhe u larguan, duke lënë ndërtesën dhe duke u shpërndarë në drejtime të ndryshme. Konstatojmë se veprimet e ndërmarra nga ana e Policisë Bashkiake, Tiranë, ishin të pabazuara në ligj, të kryera në kushte të vështira atmosferike dhe në një orar të papërshtatshëm. Si rezultat i këtyre veprimeve nga informacionet e ardhura ka rezultuar se pjesa më e madhe e këtyre familjeve kanë fjetur jashtë, në rrugë.

- Komunikimi me bashkitë e tjera pritëse.

Avokati i Popullit, bazuar në konfirmimin e dhënë nga ana e Bashkisë Tiranë mbi bashkëpunimin dhe marrëveshjen që kishte vendosur me bashkitë ku edhe do të vendopseshin familjet Rome/Egjiptiane, pas largimit nga zona e Liqenit Artificial, Tiranë, ka kërkuar informacion zyrtar iu drejtuar në datë 29.10.2015 nëpërmjet shkresave zyrtare përkatëse, Bashkisë Elbasan, Bashkisë Berat, Bashkisë Pogradec dhe Bashkisë Devoll. Kanë qënë pikërisht këto njësi të qeverisjes vendore të identifikuar si vendet, në të cilat një pjesë e mirë e familjeve të sipërcituara kishin edhe regjistrimin e tyre në gjedjen civile. Për këtë arsye është informacion nga ana e tyre lidhur me çështjet:

- a) nëse kishte patur marrëveshje paraprake mes Bashkive respektive dhe Bashkisë Tiranë, lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rome/egjiptiane nga zona e Liqenit Artificial;
- b) nëse kishte familje rome/egjiptiane të zhvendosura nga zona e Liqenit Artificial të Tiranës dhe që ishin vendosur tashmë, në territorin juridiksional të këtyre bashkive;
- c) cilat ishin masat që ishin ndërmarrë nga ana e këtyre Bashkive, për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për strehim për këto familje rome/egjiptiane;
- ç) cilat ishin procedurat dhe veprimet që po ndiqeshin nga strukturat sociale të këtyre Bashkive, lidhur me integrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në vendet ku ishin vendosur tashmë këto familje, duke përfshirë arsimimin e fëmijëve, ofrimin e vendeve të punës, përfshirjen në programet e ndryshme sociale të strehimit, apo të ndihmës ekonomike;
- d) nëse strukturat e shërbimit social të këtyre Bashkive kishin bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve dhe, nëse ishte evidentuar konkretisht numri dhe gjendja e familjeve të vendosura në këto bashki;
- dh) çdo informacion tjetër që kishte të bënte me këtë çështje, duke synuar sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura.

Në përgjigje të shkresave tona zyrtare, ka ardhur një përgjigje nga ana e Kryetarit të Bashkisë Devoll, Kryetarit të Bashkisë Elbasan, Kryetarit të Bashkisë Berat dhe në një kohë më të vonëshme nga ana e Kryetarit të Bashkisë, Berat.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Devoll, jemi informuar me shkresën me nr. 690 datë 02.11.2015 (*shih Aneks 7*), se kjo njësi e qeverisjes vendore dispononte dokumentacionin e gjendjes civile vetëm për një familje, e cila nuk kishte qenë asnjëherë rezidente në territorin e kësaj bashkie dhe nuk kishte aplikuar asnjëherë, për të përfutur nga programet e strehimit social. Në përgjigje nuk shprehej fakti nëse kishte pasur marrëveshje me Bashkinë Tiranë, lidhur me lehtësimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të strehimit për familjet që do të riktheheshin.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Berat jemi informuar me shkresën me nr. 3188/1 datë 06.11.2015 (*shih Aneks 8*), se kjo bashki ishte njoftuar nga ana e Bashkisë Tiranë, përmes e-mailit për numrin dhe listën e plotë të familjeve. Nga informacioni i përcjellë, rezultonin 19 familje që kishin të drejtën e banimit në Bashkinë Berat, por 4 prej tyre nuk kishin jetuar asnjëherë në Berat. Në mënyrë të veçantë theksohej fakti se, mes Bashkisë Berat dhe Bashkisë Tiranë nuk kishte marrëveshje paraprake për rikthimin e këtyre familjeve, duke hedhur në këtë mënyrë poshtë qëndrimet e mbajtura nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur me marrëveshjet e lidhura me bashkitë pritëse për lehtësimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të strehimit për familjet që do të riktheheshin. Në vijim, Kryetari i Bashkisë Berat, na ka informuar se pas verifikimeve të kryera për familjet që ishin rikthyer, kishte rezultuar që 10 familje kishin banesa për të jetuar, por në kushte jo të mira, dy familje jetonin në çadra, ndërsa pesë familje nuk kishin fare banesa në territorin e Bashkisë Berat.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Elbasan jemi informuar me shkresën me nr. 6040/1 datë 09.11.2015 (*shih Aneks 9*), se:

- Bashkia Elbasan nuk kishte asnjë komunikim zyrtar dhe për rrjedhojë nuk kishte asnjë marrëveshje paraprake me Bashkinë e Tiranës, për këto familje rome/egjiptiane.
- Sipas verifikimeve në të gjashtë njësitet administrative të Bashkisë Elbasan, nuk rezultonte asnjë familje që ishte paraqitur pranë këtyre njësive për trajtim të mëtejshëm.
- Bashkia Elbasan nuk kishte anjë plan, apo strategji, në lidhje me trajtimin e problemeve të strehimit të familjeve rome/egjiptiane, që kishin jetuar në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Pogradec, jemi informuar me shkresën me nr. 1332/4 datë 1.12.2015 (shih Aneks 10), se:

- *Në lidhje me "Planin e Veprimit të Bashkisë Tiranë, për të zhvendosur romët tek liqeni", drejt vendeve të origjinës ju vëmë në dijeni ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Bashkisë të Tiranës ka pasur një shkëmbim informacioni, e-mail, për një familje të vetme, me kryefamiljar shtetasin G.Z. Sipas shkresës kjo familje ka katër anëtarë dhe sipas interesimit të Bashkisë Pogradec, origjina e saj korrespondon me fshatin Qershizë, të njësisë administrative Çerravë, Pogradec.*
- *Sipas informacionit të dërguar nga ana e Njësisë Administrative Çerravë, në Bashkinë Pogradec, me shkresën nr.88 datë 9.11.2015, si dhe nga ZVRPP, Pogradec, me shkresën nr.3781/1 datë 10.11.2015, rezulton se, kjo familje nuk ka asnjë prone apo banesë, në fshatin Qershizë. Po kështu, sipas përgjigjes, kjo familje nuk është paraqitur të kontaktojë me përfaqësues të Bashkisë Pogradec, për të marrë mbështetjen e duhur.*

Ky qëndrim i mbajtur dëshmon sërish faktin se Bashkia Tiranë nuk kishte planifikuar dhe krijuar kushtet për një zhvendosje të përshtatshme, si edhe krijim të kushteve dinjitoze dhe më të mira, për jetesën dhe strehimin e familjeve rome/egjiptiane në vendet e reja të banimit.

Nga ana tjetër duhet theksuar fakti se shumë prej familjeve të rikthyera në qytetin e Tiranës, të vendosura në afërsi të zonës ku kishin jetuar më parë (zona e Liqenit Artificial) dhe të dëbuara nga ana e punonjësve të Bashkisë Tiranë, mbrëmjen e datës 7 Nëntor 2015, kanë dëshmuar faktin se, nga ana e Bashkive pritëse kanë marrë vetëm një vërtetim që kishin aplikuar për tu trajtuar në programet sociale të strehimit. Ndërkohë ata kanë pohuar faktin se nuk ishte marrë asnjë masë konkrete nga ana e strukturave të Bashkive Elbasan, Berat, Pogradec dhe Devoll, për kushtet e tyre të jetesës pas zhvendosjes, duke patur parasysh situatën dhe kushtet në të cilat ato ndodheshin.

- *Komunikimi me Shërbimin Social Shtetëror.*

Bazuar në pretendimin e Bashkisë Tiranë, sipas së cilës një prej varianteve të akomodimit të familjeve rome/egjiptiane, ishte edhe akomodimi në Qendrën Kombëtare të Emergjencave në Tufinë, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresën me nr. K3/I91-13 datë 29.10.2015 (shih Aneks 11), Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Social Shtetëror, duke i kërkuar shprehimisht informacione dhe shpjegime zyrtare lidhur me faktet:

c) nëse kishte familje të ish-komunitetit rom/egjiptian, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial të Tiranës, të cilat ishin akomoduar tashmë në QKTE, Tufinë;

d) sa ishte numri i tyre dhe cilat ishin masat konkrete të ndërmarra nga strukturat e SHSSH-së, për trajtimin e tyre social, si dhe për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatëshme dhe të qëndrueshme për strehimin e këtyre familjeve;

e) nëse kishte patur marrëveshje paraprake mes Bashkisë Tiranë dhe Shërbimit Social Shtetëror, lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rom/egjiptiane dhe akomodimin e tyre në QKTE;

ç) cilat ishin procedurat dhe veprimet që ndiqeshin nga strukturat e SHSSH lidhur me pranimin në QKTE, për akomodimin, integrimin dhe krjimin e kushteve të përshtatshme të jetesës. Sa zgjaste periudha e qëndrimit të këtyre familjeve në Qendër, si edhe cilat ishin nismat sociale për riintegrimin e tyre në shoqëri, duke patur parasysh faktin se Qendra ka status tranzitor dhe nuk mund të ofrojë një qëndrim të përhershëm;

d) nëse SHSSH kishte bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve që kishin jetuar në zonën e Liqenit Artificial, të Tiranës dhe cilat ishin problematikat e evidentuara nga strukturat respektive;

dh) çdo informacion tjetër që kishte të bënte me çështjen, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura. Në përgjigje të kërkesës tonë zyrtare, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Social Shtetëror, na ka informuar me shkresën me nr. 2233/1 datë 10.11.2015, se në Qendrën Kombëtare të Emergjencave në Tufinë ishte akomoduar vetëm një familje rom, e përbërë prej tre anëtarësh (një nënë dhe dy fëmijët e saj të mitur). Nuk kishte asnjë marrëveshje të shkruar me Bashkinë e Tiranës, lidhur me trajtimin e situatës së komunitetit rom/egjiptian të zones së Liqenit Artificial, por kishte komunikim institucional lidhur me menaxhimin e situatës së krijuar, brenda kompetencave të secilës palë. Po ashtu theksohet fakti se, nuk kishte asnjë studim paraprak nga strukturat e posaçme të SHSSH-së, për situatën e familjeve të këtij komuniteti banorësh.

Së fundmi, duhet theksuar fakti se banorë të komunitetit rom/egjiptian pranë zonës së Liqenit Artificial i kanë dëshmuar ekspertëve të institucionit të Avokatit të Popullit, kërcënimet dhe presionet që u janë bërë veç të tjerash edhe nga një individ, anëtar i minoritetit Rom, aktualisht me detyrë, punonjës i Shërbimit Social Shtetëror, kujdestar pranë Qendrës Kombëtare të Emergjencave, në Tufinë.

Megjithatë Drejtori i SHSSH-së i ka bashkëngjitur përgjigjes zyrtare një procesverbal të mbajtur nga ana e disa punonjësve të këtij institucioni, në zonën e Liqenit Artificial, ku ndër të tjera thuhet se punonjësit e SHSSH u bënë pre e kërcënimeve të banorëve, nga ana e banorëve të këtij komuniteti është dëshmuar se ka qënë pikërisht një punonjës i QKTE dhe njëkohësisht pjesëtari i komunitetit rom, i cili ka ushtruar presion dhe ka bërë kërcënime ndaj banorëve për të pranuar variantin e ofruar të zhvendosjes dhe për tu akomoduar më pas në QKTE.

- ***Komunikimi me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, Tiranë.***

Nga kontaktet me banorët e këtij komuniteti, ekspertëve të Avokatit të Popullit ju është parashtruar pretendimi se, nga ana e punonjësve të Bashkisë Tiranë, ju janë dhënë shuma monetare që variojnë nga 10.000-20.000 lek të reja, me

qëllim për t'u larguar nga vendbanimi i tyre i përkohshëm në atë zonë. Nga ana jonë nuk është zbuluar dot dhe nuk kemi informacion mbi burimin e këtyre shumave, mënyrën e pagesës, si edhe shkakun e ligjshëm për të cilin u janë dhënë banorëve këto shuma parash.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit i është drejtuar Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë, me shkresën me nr. K3/I118-6 Datë 16.10.2015 (*shih Aneks 12*), duke e njoftuar mbi sa më sipër dhe duke kërkuar nga ana e strukturave të posaçme të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë, që të na vinin në dijeni mbi procedurat e veprimet konkrete që do të ndiqeshin për hetimin e kësaj çështjeje.

Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar është dërguar edhe një fotokopje e proces-verbalit të mbajtur nga ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit, me njërin nga banorët e komunitetit Rom/Egjiptian, me qëllim kryerjen e verifikimeve të mëtejshme nga ana e strukturave të Drejtorisë së Policisë, së Qarkut Tiranë.

Nuk ka ende përgjigje zyrtare nga ane Drejtorit të Drejtorisë së Policisë, së Qarkut Tiranë.

6.Situata pas zhvendosjes së plotë, nga zona e Liqenit Artificial, Tiranë.

Nga informacionet e marra nga vetë banorët e prekur nga kjo zhvendosje, por edhe nga komunikimet e vazhdueshme në terren me aktivistë të çështjes rome, na rezulton se një pjesë e mirë e familjeve të zhvendosura, nuk janë larguar dhe vendosur tashmë në qytetet ku edhe atat kanë regjistrimin në gjendjen civile, për shkak të mungesës së kushteve minimale të strehimit dhe mungesës së kushteve për punësimin e tyre. Konkretisht, ato janë vendosur në zonën e Bregut të Lumit, Tiranë, e cila rezulton zonë me popullsi Rome. Megjithatë, rreziku i përsëritjes së një zhvendosje të re nga kjo zonë ekziston, pasi aty mund të ndërmerren nga ana e Bashkisë Tiranë, punime publike.

Po ashtu, nga komunikimi që kemi patur me një numër të madh të organizatave të shoqërisë civile ka rezultuar se një pjesë e familjeve, duke përfshirë këtu edhe familjet që u dëbuan nga prona private me datë 07.11.2015, janë strehuar dhe akomoduar në banesa private, me mbështetjet logjistike dhe financiare të këtyre organizatave. Kjo në të kundërt të qëndrimit të Bashkisë Tiranë për ofrimin e munguar të mundësive alternative të strehimit dhe shmangien e zhvendosjes, derisa atyre tu sigurohej strehim alternative, sipas varianteve që ishin afruar paraprakisht në mënyrë verbale nga punonjësit e Bashkisë Tiranë. Konkretisht, nga të dhënat që kemi marrë nga "Qendra Ditore për Fëmijët në Situatë Rruge", rezulton se 11 familje janë të strehuar aktualisht në banesa me qira, ndërkohë që po shihej mundësia për gjetjen e banesave për 5 familje të tjera. Mbështetje në të gjithë këtë proces aspak të lehtë, është siguruar edhe nga organizata "Save the Children".

7.Konkluzione:

Bazuar në trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e Bashkisë Tiranë, por edhe nga konstatimet e bëra nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit konstatohet se:

- Krahas gjithë problematikave të tjera të evindetuara në aktivitetin e Avokatit të Popullit, të cilat janë sensitive për jetesën normale të minoritetit Rom në Shqipëri, problematikë shqetësuese mbetet

çështja e zhvendosjes së komuniteteve Rome/Egjiptiane, nga vendqëndrimet e tyre të vendosura në prona publike, apo edhe private. Kjo situatë ka ndodhur efektivisht edhe me komunitetin Rom/Egjiptian, të vendosur prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

- Nga të dhënat e marra në terren, pasi të dhënat e detajuara zyrtare nuk na janë dërguar nga ana e Bashkisë Tiranë sot e kësaj dite, na ka rezultuar se komuniteti i vendosur në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, kishte rreth 50 familje Rome/Egjiptiane, që banonin afërsisht në po të njëjtin numër barakash. Ky komunitet përbëhej nga rreth 200 individë, mes të cilëve gra, fëmijë, pleq, të cilët kishin një periudhë prej më shumë se 5 vitesh, që banonin në barakat që kishin ndërtuar vetë.
- Sipas rekomandimeve të OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jursiprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti ka detyrim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit të titullit të pronësisë. Pra, shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore kundër dëbimeve të detyruara, ngacmimeve dhe kërcënimeve të tjera dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.
- Bazuar në aktet e rëndësishme ndërkombëtare të OKB-së dhe organizmave të tjerë, që trajtojnë të drejtën e strehimit, në Rekomandimin e Komitetit të Këshillit të Europës, Rec (2005) 4, "Për përmirësimin e kushteve të strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Europë", si dhe në Komentin e Përgjithshëm nr.7 të Komitetit, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara për strehimin ka publikuar një numër udhëzimesh të detajuara, të njohura si Parimet dhe Udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe *Udhëzimet për lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen*. Këto parime dhe udhëzime bëjnë më të qarta detyrimet e shtetit në rastet e lirit me forcë të banesave.

Masat që jepen në këto parime dhe udhëzime kanë si qëllim që të ofrojnë orientime të qarta për zyrtarët dhe politikëbërësit për procedurat dhe masat që duhen marrë, për të dhënë sigurinë se lirimi i banesës është bërë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

- Sikurse kemi evidentuar paraprakisht edhe në rekomandimin tonë, dërguar Bashkisë Tiranë, me shkresën nr. K1/I118-4 datë 08.10.2015, në trajtimin e kësaj çështjeje na ka rezultuar se:
 - a) Zhvendosja e komunitetit rom/egjiptian, është kryer pa patur një akt zyrtar administrativ bazë, produkt i një procedimi normal administrativ për organet e administratës publike, ku përfshihej edhe Bashkia Tiranë. Kjo mungesë shprehjeje e vullnetit të Bashkisë Tiranë, përmes aktit administrativ përkatës ka krijuar probleme serioze me shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ndaj pjestarëve të komunitetit rom/egjiptian, në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës. Po kështu, kjo mënyrë informale veprimi ju ka hequr efektivisht atyre të drejtën për të kundërshtuar këtë akt zyrtar, në rrugë administrative, apo edhe gjyqësore.

- b) Zhvendosja është kryer në mungesë të një komunikimi dhe konsultimi të domosdoshëm, midis Bashkisë Tiranë dhe komunitetit të prekur, lidhur me përcaktimin e zgjidhjeve oportune. Në këto kushte ka munguar informacioni i plotë mbi çfarë i priste këta qytetarë dhe kjo situatë ka rënduar më tej gjendjen e tyre të vështirë, duke krijuar një tjetër problem edhe më të mprehtë social.
- c) Bashkia Tiranë nuk ka disponuar një plan të mirëmbënuar, të mbështetur në një njohje të plotë të tipologjisë së komunitetit, gjendjes të secilës prej familjeve, qoftë në aspektin e aksesit për një strehë të sigurt, aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, gjendjen e tyre ekonomike dhe të pasojave që do të vuante secila prej tyre, në rast zhvendosje, nga zona e Liqenit Artificial, të Tiranës. Situata në fjalë ndërthur jo vetëm cënimin e së drejtës për strehim të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, por edhe cënimin e së drejtës për jetën familjare, si dhe të drejtën e tyre për jetën.
- d) Zhvillimi i situatës së zhvendosjes së këtij komuniteti është përcjellë, si nga ana e Bashkisë Tiranë, ashtu edhe nga ana e disa mediave, me një gjuhë e cila krijonte premisë për nxitjen e urrejtjes dhe përforconte stereotipe krejtësisht të dëmshme për një shoqëri demokratike, që ushqejnë qëndrime diskriminuese kundrejt këtij komuniteti.
- e) Zhvendosja, apo dëbimi i paralajmëruar me forcë i këtyre familjeve përbënte një ngjarje të përsëritur për komunitetet e përkatësisë Rome, apo edhe Egjiptiane, të vendosura në zona periferike, në qytetet më të mëdha të vendit. Zhvendosja e familjeve rome/egjiptiane nga parku i liqenit, e cila përpos mosrespektimit të parimeve të sipërcituara ndërkombëtare, ka përjashtuar këtë komunitet nga komunikimi, informimi dhe pranimi i zgjidhjes së ofruar me marrëveshje nga vetë anëtarët e këtij komuniteti përbën thjesht dhe vetëm një situatë dëbimi me forcë, që shkel rëndë të drejtat e tyre. Ky nuk është rasti i vetëm ku evidentohet zhvendosje me forcë e komuniteteve rome, pasi ndër vite kanë ndodhur situata të ngjashme, sikurse me komunitetin Rom pranë ish “Stacionit të trenit”, në Tiranë, në zonën pranë “Pallatit me shigjeta”, në rrugën e Kavajës, Tiranë, etj.
- f) Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, zhvendosja (dëbimi me forcë) e këtij komuniteti, nuk është kryer në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme dhe nuk ka respektuar detyrimet e parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.
- g) Zhvendosja e komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, të Tiranës, si një çështje me përmasa delikate të aspektit juridik dhe social duhej të trajtohej duke respektuar të drejtat e këtij komuniteti dhe duke parashtruar zgjidhje konkrete, efektive, të qëndrueshme dhe afatgjata, me qëllim garantimin e një jetese më të mirë dhe jo përkeqësimin e saj.

Alternativat e ofruara nga ana e Bashkisë Tiranë për vetë mungesën e koherencës së tyre, mungesën e bashkëpunimit real me Bashkitë Elbasan, Pogradec, Berat dhe Devoll, si dhe pamundësinë e trajtimit të tyre në Qendrën e Emergjencave Civile, në Tufinë, Tiranë, nuk ishin zgjidhje në thelb e problematikës së familjeve të komunitetit në fjalë. Kjo mënyrë trajtimi ka ndodhur në një kohë kur, institucioni i Avokatit të Popullit prej kohësh apelon dhe rekomandon me forcë, për zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që përmirësojnë realisht kushtet e jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.

- h) Problematike në këtë çështje ka qënë situata e paqartë e pronësisë mbi truallin ku ishte vendosur ky komunitet, pasi Bashkia Tiranë pretendonte se kishim të bënim me truall shtetëror, ndërkohë që vet komuniteti dhe persona pretendentë si pronarë private, flisnin për truall në pronësi private. Nga verifikimi i kryer nga ana jonë përmes informacionit të marrë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme, Tiranë, si dhe nëpërmjet ekspertizës së nevojshme të pavarur, ka rezultuar se sipërfaqja e tokës ku ishte vendosur ky komunitet është pjesërisht shtetërore, dhe pjesërisht private. Veprime e kryera në pronësinë private nga ana e Bashkisë Tiranë, janë krejtësisht në tejkalim të juridiksionit dhe kompetencave të përcaktuara me ligj nga ana e kësaj institucioni. Duke analizuar edhe elementët e tjerë të shkeljeve ligjore të konstatuara në trajtimin e kësaj çështjeje nga ana e Bashkisë Tiranë, ky fakt rëndon pozitën e institucionit të Bashkisë Tiranë, në ndërhyrjen e kryer për zhvendosjen e komunitetit Rom/Egjiptian, në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë.
- i) Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit zyrtar të kërkuar në kuadër të hetimit administrative të çështjes, ende sot e kësaj dite dëshmon mungesën e transparencës në veprimet e ndërmarra nga Bashkia Tiranë, në situatën e krijuar me zhvendosjen e familjeve komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë. Njëkohësisht, kjo mungesë përbën edhe refuzim për bashkëpunim me institucionin e pavarur, të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit, Avokatin e Popullit.
- j) Sikurse rezulton më pas gjendja e familjeve të komunitetit rom/egjiptian, që ishte vendosur dhe më pas dëbuar nga zona e Liqenit Artificial, në Tiranë, nuk është përmirësuar pas largimit nga kjo zonë, por përkundrazi është përkeqësuar. Rikthimi i disa familjeve afër së njëjtës zonë, shpërndarja e tyre në komunitetet e tjera rome në Tiranë, si dhe mungesa e një plani konkret për përmirësimin e jetesës së tyre pas zhvendosjes, tregon se kjo ngjarje nuk zgjidhi problematikat shqetësuese të këtij komuniteti, por i rëndoi ato, duke krijuar një rreth vicioz përsëritës, të problemit dhe të moszgjidhjes së tij.
- k) Avokati i Popullit përmes qëndrimit të tij proaktiv konstaton se, ky është një rast i përsëritur që, përpos mungesës së një legjislacioni të nevojshëm specifik vendas, për trajtimin e rasteve të zhvendosjeve me dhunë, nxjerr nevojën imediate të

implementimit të parimeve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje dhe që janë të detyrueshme për shtetin shqiptar.

- I) Duke folur me gjuhën e më të dobët, theksojmë se sot është koha për të gjetur zgjidhje, të cilat integrojnë natyrshëm minoritetin Rom në shoqërinë shqiptare, minoritet ky që ende nuk ka gjetur paqen sociale të merituar.

ANEKS 1

ANNEX 1



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *21/E118-4* Prot.
Nr. Dok. 201501869/4

Tiranë *08/10/2015*

Lënda : *Për trajtimin e situatës së komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, në Tiranë.*

Drejtuar : Kryetarit të Bashkisë Tiranë
Z. Erion VELIAJ

Tiranë

Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Tiranë
Z. Aldrin DALIPI

Tiranë

Për dijeni: Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë
Z. Edi RAMA

Tiranë

Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë
Z. Blendi KLOSI

Tiranë

Ministrit të Punëve të Brendëshme
Z. Saimir TAHIRI

Tiranë

Ministres së Zhvillimit Urban
Zj. Eglantina GJERMENI

Tiranë

Të nderuar zonja/zotërinj,

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë

4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve më të fundit që lidhen me ndërhyrjen që parashikohet të ndërmerret nga ana e Bashkisë Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 2.10.2015, në ëbsite "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome/egjiptiane që jetojnë në këtë zonë, institucioni juaj është angazhuar me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe është pronë publike.

Po sipas rubrikës, Bashkia Tiranë ka konstatuar se, problematikat e vendqëndrimit abuziv dhe të paligjshëm të familjeve Rome janë të shumta, ndaj edhe ka vendosur që t'i largojë ato.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me inisiativë të kësaj çështjeje.

Për shkak të emergjencës që paraqet trajtim i kësaj çështjeje, kemi kërkuar paraprakisht shpjegime nga ana e Bashkisë Tiranë, lidhur masat që janë marrë nga ky institucion për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Paraprakisht kemi kërkuar të vihemi në dijeni të faktit nëse Bashkia Tiranë ka kryer një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu kemi kërkuar informacion edhe mbi mënyrën se si është menduar dhe se, si do të zgjidhet problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na dhënë një kopje të njoftimit zyrtar që iu është komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku banojnë, brenda afatit 10 ditor.

Paralelisht, janë marrë kontakte në terren me familjet Rome/Egjiptiane të vendosura në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, si dhe me organizta joqeveritare apo me aktivistë Romë, që ushtrojnë aktivitet në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian në Shqipëri.

Nga të dhënat paraprake të marra në terren rezulton se, janë rreth 50 familje Rome/Egjiptiane të vendosura në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, që banojnë afërsisht në po të njëjtin numër barakash. Ky komunitet përbëhet nga rreth 200 individë, mes të cilëve gra, fëmijë, pleq, të cilët kanë një periudhë prej rreth 5 vjet që banojnë në barakat që kanë ndërtuar vetë.

Pavarësisht njoftimit që ka dalë në media nga ana e Bashkisë Tiranë për zhvendosjen e tyre, banorët e këtij komuniteti janë shprehur se nuk kanë patur asnjëherë njoftim zyrtar mbi këtë zhvillim të papritur për ta. Sipas tyre kontakti direkt i përfaqësuesve të këtij institucioni, me banorët e komunitetit ka filluar vetëm ditën e dielë, datë 04.10.2015 kur edhe ata kanë shkuar në këtë zonë dhe kanë filluar të marrin të dhëna për familjet që janë vendosur aty. Sipas deklarimeve të vetë komunitetit familjet e vendosura në këtë zonë janë të ardhur kryesisht nga qytetet e Elbasanit, Beratit, por ka edhe familje të cilat

janë vendosur aty pas shpërnguljes me forcë të ndodhur para disa vitesh nga zona e ish Stacionit të Trenit në Tiranë, apo edhe nga zona e "Pallatit me shigjeta", në rrugën e Kavajës në Tiranë.

Zhvendosja e tyre nga qytetet e tjera të vendit, apo të zonave të tjera të Tiranës sipas tyre ka ndodhur për shkak të pamundësisë për të siguruar të ardhura të mjaftueshme dhe të një jetese më të mirë për këto familje. Aktiviteti kryesor me të cilin merren pjestarët e tyre të angazhuar me punë është mbledhja e bidonave plastikë, apo e kanaçeve në vendet e hedhjes së mbeturinave, për t'i shitur më pas në pikat përkatëse të grumbullimit të tyre.

Të nderuar zonja/zotërinj,

Situata e cila po trajtohet në këtë rekomandim për shkak të vet mënyrës se si po vepron Bashkia Tiranë, po paraqitet në kushtet e një ndërhyrje të domosdoshme dhe urgjente nga ana e Avokatit të Popullit, pasi në datë 07.10.2015, në shkelje të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë, u ushtrua presion për zhvendosjen e këtyre familjeve, nëpërmjet prezencës së një numri të madh punonjësish të Policisë Bashkiake, Tiranë, në zonën ku ndodhet ky komunitet.

Pavarësisht përpjekjeve tona institucionale për sqarimin e kësaj gjendjeje dhe marrjes së një informacioni të nevojshëm nga ana e Bashkisë Tiranë, për trajtimin e saj, ende nuk kemi një përgjigje zyrtare dhe nuk na është vënë në dispozicion asnjë dokument nga Bashkia e Tiranës.

Për të kuptuar gjendjen e krijuar, na lejoni të sjellim në vëmendjen tuaj, pikërisht ato parime dhe standarde ndërkombëtare mbi bazën e të cilave duhej të trajtohej dhe aktualisht, të trajtohet kjo çështje.

Sipas rekomandimeve të OKB-së dhe interpretimeve të dhëna në jursiprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, shteti ka detyrim të menjëhershëm dhe të vazhdueshëm për të siguruar që të gjithë personat të kenë siguri në zotërim të banesës, pavarësisht disponimit të titullit të pronësisë. Pra shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore kundër dëbimeve të detyruara, ngacmimeve dhe kërcënimeve të tjera dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Janë disa parimet themelore që duhet të reflektohen në masat e domosdoshme që ndërmerren në proceset (procedurat) e dëbimit me forcë dhe më konkretisht:

- mosdiskriminimi para ligjit,
- detyrimi i përmbushjes progresive të detyrimit për strehim nga ana e shtetit, duke përdorur burimet maksimale në dispozicion, përpara se të kryhet dëbimi dhe prishja e banesës,
- kërkimi dhe pranimi i ndihmës ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me organizma ndërkombëtarë ose OJF,
- dhënia e prioritetit individëve më të rrezikuar dhe më të marginalizuar,
- krijimi i aksesit të plotë dhe në kohë të përshtatshme për informacion,
- pjesmarrja efektive e komunitetit në bisedime dhe në proceset vendimmarrëse,

- llogaridhënia e autoriteteve përgjegjëse.

Në Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 4, për të drejtën për një strehim të përshtatshëm, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përcakton se e drejta për strehim nuk duhet të barazohet me pasjen e një çatie mbi kokë, por ajo duhet pare si një e drejtë për të jetuar diku në siguri, paqe dhe dinjitet. Në vazhdim ky Komitet ka përcaktuar se e drejta për strehim është një e drejtë e shumëanshme, që përbëhet nga shtatë aspekte, të cilat duhen përmbushur në mënyrë që të zbatohet plotësisht:

1. Siguria ligjore e posedimit/zotërimit,
2. Mundësia (shërbimeve, materialeve, dhe infrastrukturës),
3. Përballueshmëria,
4. Jetueshmëria,
5. Aksesueshmëria
6. Vendndodhja (e cila duhet të lejojë akses në tregun e punës, shëndetësi, arsim, kujdes për fëmijët dhe lehtësira të tjera sociale),
7. Përshtatshmëri kulturore.

Në çdo rast duhet theksuar se të gjitha parimet e parashikuara në këtë fushë, janë të reflektuara gjithashtu edhe në Rekomandimin e Komitetit të Këshillit të Europës, Rec (2005) 4, "Për përmirësimin e kushteve të strehimit të Romëve dhe Udhëtarëve në Europë".¹

Bazuar në këto akte të rëndësishme ndërkombëtare dhe në Komentin e Përgjithshëm nr.7 të Komitetit, Raporteri Special i Kombeve të Bashkuara për strehimin ka publikuar një numër udhëzimesh të detajuara, të njohura si Parimet dhe Udhëzimet bazë të Kombeve të Bashkuara dhe *Udhëzimet për lirimet bazuar mbi Zhvillimet dhe mbi Zhvendosjen*. Këto parime dhe udhëzime bëjnë më të qarta detyrimet e shtetit në rastet e lirit me forcë të banesave.

Masat që jepen në këto parime dhe udhëzime kanë si qëllim që të ofrojnë orientime të qarta për zyrtarët dhe politikëbërësit për procedurat dhe masat që duhen marrë, për të dhënë sigurinë se lirimi i banesës është bërë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Sipas tyre, lirimi i banesës në kushtet e dëbimit me forcë kalon në tre faza, si vijon:

- a) **Përpara lirit të banesës:** Bazuar në parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, lirimi i banesës duhet të konsiderohet si mjeti i fundit dhe pasi janë shqyrtuar të gjitha alternativat. Pra autoritetet publike, kanë barrën për të provuar se, dëbimi është i pashmangshëm për interesa publike. Duhet zhvilluar konsultime të vazhdueshme ku të ftohen të marrin pjesë të gjithë personat e prekur, ndërkohë që autoritetet nxisin pjesmarrjen e grave. Me qëllim që konsultimet të jenë efektive, autoritetet duhet t'u ofrojnë atyre që preken të gjithë informacionin e nevojshëm, që lidhet me arsyet për lirin e banesës, oraret e punës që do të kryhet, si dhe dhënien e kohës së nevojshme atyre që preken dhe avokatëve të tyre për të dhënë alternativat, komentet, sugjerimet, për planet e autoriteteve. Rezultati më ideal i këtyre përpjekjeve do të ishte përfundimi i një marrëveshjeje mes autoriteteve shtetërore dhe personave që do të

¹ Website: wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=825545

lirtojnë banesën, ku rregullohen të gjitha aspektet e lirit të banesës dhe ofrohen alternativa për strehim.

Shtetet duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantojnë se grupeve vulnerable si Romëve/Udhëtarëve u duhen ofruar mundësi të përshtatshme për të rregulluar strehimin e tyre dhe mosmarrja në konsideratë e nivelit të tyre të mohimit përgjatë viteve ku hartohen kërkesat e nevojshme për rregullimin e strehimit, mund të çojë në diksriminim të tërthortë.

Kjo është e rëndësishme jo vetëm për t'ju dhënë strehim atyre, por edhe për t'i ofruar sigurinë ligjore shtesë, për sa kohë që shtëpitë e paligjshme janë më shumë subjekt i prishjeve.²

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, thekson se prishja e shtëpive të paligjshme dhe krijimi i qytetit të barakave mund të jetë rezultat i mungesës së politikave efektive të strehimit. Për pasojë është e papranueshme, për të mos thënë e padrejtë, që të penalizosh ata njerëz që nuk kanë asnjë mbështetje nga shteti dhe që janë munduar të rregullojnë problemet e tyre të strehimit me të gjitha mënyrat që ata mundën, duke ushtruar të drejtën e "vetë-ndihmës".

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj njih gjykime të tilla si: Yordanova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, apo Lilitana Assenova Naidenova dhe të tjerë kundër Bullgarisë, ku theksohet se shkelje e të drejtave të njeriut konsiderohet në këto raste mungesa e ofrimit të çdo forme alternative të strehimit për Romët dhe familjet e tyre gjatë kohës që u lejua dëbimi, si dhe për faktin se autoritetet kishin lejuar Romët të jetonin atje për shumë vite dhe nuk mund t'i urdhëronin papritur që të largoheshin dhe të ndërprisnin jetën e tyre familjare dhe komunitare që kishin zhvilluar gjatë viteve.

- b) **Gjatë lirit të banesës:** Theksohet se kjo ndodh kur liri i banesës është i pashmangshëm dhe ai nuk mund të kryhet kur është mot i keq, gjatë festimeve zyrtare, gjatë natës, ose kur banuesit nuk ndodhen aty. Përdorimi i forcës duhet të ndodhë plotësisht në përputhje me parimet bazë të Kombeve të Bashkuara, për përdorimin e forcës.
- c) **Pas lirit të banesës:** Liri i banesës i pashoqëruar me ofrimin e alternativave të strehimit mund të konsiderohet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare vetëm në raste shumë përjashtimore. Në çdo rrethanë tjetër, autoritetet duhet të sigurojnë se ato që janë nxjerrë jashtë, kanë akses ndër të tjera në strehime dhe shtëpi, si dhe në shërbimet shëndetësore, ato të edukimit etj, dhe se liri me forcë nuk duhet t'i kthejë ata në të pastrehë. Për më tepër, autoritetet nuk duhet të injorojnë asnjëherë aspektin gjinor dhe duhet gjithmonë të përpiqen që të nxisin pjesëmarrjen e grave në të gjitha procedurat e nevojshme. Një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar mirëqënies së grave dhe fëmijëve. Autoritetet duhet të monitorojnë dhe ndjekin kushtet sociale dhe shëndetësore të atyre që shpërngulen, veçanërisht në rastet e shpërnguljes së të gjithë komunitetit.

² Ankim kolektiv nr.31/2005, Qendra Evropiane e të Drejtave të Romëve kundër Bullgarisë, vendim themeli miratuar në 18 Tetor 2006.

Por çfarë ndodh realisht sot me situatën e krijuar për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës?

Avokati i Popullit, konstaton se:

1. Zhvendosja aktuale e komunitetit rom/egjiptian, po kryhet pa patur një akt zyrtar administrativ bazë, produkt i një procedimi normal administrativ për organet e administratës publike, ku përfshihet edhe Bashkia Tiranë. Kjo mungesë shpreheje e vullnetit të Bashkisë Tiranë, përmes aktit administrativ përkatës krijon probleme serioze me shkeljen e së drejtës për një proces të rregullt ligjor ndaj pjestarëve të komunitetit rom/egjiptian në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës. Po kështu, kjo mënyrë informale veprimi ju heq të drejtën atyre të kundërshtojnë këtë akt zyrtar, në rrugë administrative, apo edhe gjyqësore.
2. Zhvendosja po kryhet në mungesë të një komunikimi dhe konsultimi të domosdoshëm, midis Bashkisë Tiranë dhe komunitetit të prekur, lidhur me përcaktimin e zgjidhjeve. Në këto kushte mungon informacioni i plotë mbi çfarë i pret këta qytetarë dhe kjo situatë rrezikon të rëndojë më tej gjendjen e tyre të vështirë, duke krijuar një tjetër problem edhe më të mprehtë social.
3. Sikurse del nga mënyra e trajtimit të deritashëm, por edhe nga informacioni që kemi deri më sot, Bashkia Tiranë nuk ka një plan të mirëmbëduar, të mbështetur në një njohje të plotë të tipologjisë së komunitetit, gjendjes të secilës prej familjeve, qoftë në aspektin e aksesit për një strehë të sigurt, aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, gjendjen e tyre ekonomike dhe të pasojave që do të vuajë secila prej tyre, në rast zhvendosje nga zona e Liqenit Artificial të Tiranës.
4. Në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për të drejtën për strehim pasi zhvendosja e pastudjuar dhe në mungesë të konsultimit me komunitetin në fjalë, mund të çenojë dhe të drejtën e tyre për jetën familjare, si dhe të drejtën e tyre për jetën.
5. Kjo situatë po përcillet, si nga ana e Bashkisë Tiranë, ashtu edhe nga disa media, me një gjuhë e cila krijon premisë për nxitjen e urrejtjes dhe përforcon stereotipe krejtësisht të dëmshme për një shoqëri demokratike, ose të cilat ushqejnë qëndrime diskriminuese kundrejt këtij komuniteti.
6. Zhvendosja, apo dëbimi i paralajmëruar me forcë i këtyre familjeve është një ngjarje e përsëritur për komunitetet e përkatësisë rome, apo edhe egjiptiane, të vendosura në zona periferike, në qytetet më të mëdha të vendit. Shumica e këtyre ngjarjeve deri më sot janë zhvilluar në shkelje të të drejtave të komuniteteve përkatëse.
7. Ne gjykojmë se, zhvendosja (dëbimi me forcë) i këtij komuniteti, nuk po kryhet në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme; nuk po respektohen detyrimet e parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Ndërhyrja më e fundit e punonjësve të Policisë Bashkiake, të Bashkisë Tiranë, paraditen e datës 07.10.2015, të cilët kanë shkuar në zonën ku ndodhen barakat e këtij komuniteti duke bërë presion për largimin e familjeve rome/egjiptiane, vërteton edhe një herë faktin se trajtimi i kësaj çështjeje nuk po respekton asnjë nga parimet dhe standardet bazë ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë.

Si një çështje me përmasa delikate të aspektit juridik dhe social, zhvendosja e komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, të Tiranës, duhet të trajtohet duke respektuar të drejtat e këtij komuniteti dhe duke parashtruar zgjidhje konkrete, efektive, të qëndrueshme dhe afatgjata, me qëllim garantimin e një jetesë më të mirë dhe jo përqekësimin e saj. Edhe alternativa e ofruar nga ana e Bashkisë Tiranë për strehimin e disa prej këtyre familjeve në Qendrën e Emergjencave Civile, në Tufinë, Tiranë, nuk zgjidh në thelb problematikën e familjeve të komunitetit në fjalë. Kjo është një zgjidhje e përciptë, e përkohëshme, ndërkohë që institucioni i Avokatit të Popullit prej kohësh apelon dhe rekomandon me forcë për zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që përmirësojnë realisht kushtet e jetesës së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Çështja në fjalë bëhet edhe më sensitive, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e çështjes së strehimit të familjeve të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian, si dhe të respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin European.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, mungesa e kushteve minimale të jetesës së anëtarëve të këtij minoriteti është një problem serioz, jo vetëm për ata vetë si individë, por edhe për mënyrën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që ky minoritet të ndihet i diskriminuar, i pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Kjo praktikë trajtimi e çështjes u heq mundësinë familjeve Rome që të kërkojnë nga një gjykatë e paanshme që të vlerësohet rast pas rasti, nëse jemi përpara kufizimit të së drejtës për strehim nga akti i administratës publike, duke marrë parasysh të gjitha detyrimet që shteti i lindin në bazë të kërkesave të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Nëse gjykatat nuk kanë mundësinë që të marrin në konsideratë faktin që paditësit rrezikojnë të mbeten të pastrehë dhe për këtë arsye ta konsiderojë këtë rrezik iminent, të rëndë dhe të pariparueshëm, në rastet kur individët mund të jenë në kushtet e pamundësisë financiare për të siguruar banesë alternative (me qira), atëherë në mënyrë efektive kemi shkeljen e nenit 8, të KEDNJ, përmes një ndërhyrjeje joproporcionale. Më i rëndë paraqitet rasti i grupeve vulnerabël, siç edhe është komuniteti rom dhe ai egjiptian.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti European, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit:

"Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të".

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre

duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 21/b të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet përkatësisht shprehimisht se:

"Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit.....,

- *paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",*

"Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur, tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",*

REKOMANDOJMË

1. Analizimin e kujdesshëm dhe të shpejtë të gjendjes së krijuar dhe pezullimin e veprimeve të mëtejshme nga ana e Bashkisë Tiranë, sa i takon çështjes së zhvendosjes së komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, të Tiranës.

2. Zgjidhjen e situatës në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, me qëllim që këtij komuniteti t'i ofrohen zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që synojnë dukshëm përmirësimin e kushteve të jetesës së komuniteteve romë dhe egjiptiane në vend.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimet Tuaja, ndaj këtij rekomandimi.


Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

Në mungesë dhe me porosi,

KOMISIONERI


Arben SHKËMBI

ANEKS 2

ANNEX 2



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Deklaratë për median

Kërkohet pezullimi i zhvendosjes së komunitetit Rom/Egjiptian nga zona e Liqenit Artificial të Tiranës dhe zgjidhja e situatës në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë.

Prej disa ditësh po ndjekim me shqetësim situatën e krijuar lidhur me zhvendosjen e pritshme dhe të paralajmëruar nga Bashkia e Tiranës, të banorëve romë dhe egjiptianë të vendosur prej kohësh në zonën e Liqenit Artificial, në Tiranë. Zhvendosja apo dëbimi i këtyre familjeve është një ngjarje e përsëritur për komunitetet e përkatësisë rome të vendosura në zona periferike, në qytetet më të mëdha të vendit. Të gjitha këto ngjarje deri më sot janë zhvilluar në shkelje të të drejtave të komuniteteve përkatëse.

Zhvendosja aktuale e komunitetit rom/egjiptian po kryhet në mungesë të një komunikimi dhe konsultimi midis Bashkisë Tiranë dhe komunitetit të prekur, lidhur me përcaktimin e zgjidhjeve. Ne besojmë se në këto kushte mungon informacioni i plotë mbi çfarë i pret këta qytetarë dhe kjo situatë rrezikon të rëndojnë më tej gjendjen e tyre të vështirë, duke krijuar një tjetër problem edhe më të mprehtë social.

Nga informacioni që kemi deri më sot, Bashkia Tiranë nuk ka një plan të mirëmbëdhur, të mbështetur në një njohje të plotë të tipologjisë së komunitetit, gjendjes të secilës prej familjeve, qoftë në aspektin e aksesit për një strehë të sigurt, aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, gjendjen e tyre ekonomike dhe të pasojave që do të vuajë secila prej tyre, në rast zhvendosje nga zona e Liqenit Artificial, të Tiranës.

Ne gjykojmë se, zhvendosja e këtij komuniteti nuk po kryhet në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme; ajo nuk respekton të parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Theksojmë se në këtë rast nuk bëhet fjalë vetëm për të drejtën për strehim pasi zhvendosja e pastudjuar dhe në mungesë të konsultimit me komunitetin në fjalë, mund të çenojë dhe të drejtën e tyre për jetë familjare, si dhe të drejtën e tyre për jetën.

Gjithashtu dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se kjo situatë po përcillet, si nga ana e Bashkisë Tiranë, ashtu edhe nga disa media, me një gjuhë e cila krijon premisë për nxitjen e urrejtjes dhe përforcon stereotipe krejtësisht të dëmshme për një shoqëri demokratike, ose të cilat ëshqejnë qëndrime diskriminuuese kundrejt këtij komuniteti.

Si një çështje me përmasa delikate të aspektit juridik dhe social, zhvendosja e komunitetit Rom/Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, të Tiranës, duhet të trajtohet duke respektuar të drejtat e këtij komuniteti dhe duke parashtruar zgjidhje konkrete, efektive, të qëndrueshme dhe afatgjata, me qëllim garantimin e një jetesë më të mirë dhe jo përkeqësimin e saj.

Përmes kësaj deklarate ne ftojmë Bashkinë e Tiranës që të reflektojë sa më shpejt mbi këtë çështje, si dhe kërkojmë që ky institucion të pezullojë veprimet për zhvendosjen e komunitetit të sipërcituar, të ndërtojë një proces konsultues me familjet dhe të angazhohet për hartimin e një plani afatshkurtër dhe afatgjatë për zgjidhjen e kësaj çështjeje, në respekt të interesave të ligjshme të komunitetit dhe të drejtave të tyre.

Subjektet mbështetëse të deklaratës:

Institucionet publike:

- Avokati i Popullit
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Organizata jofitimprurëse;

- Arsis
- TLAS
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Fondacioni i Shoqërisë së Hapur për Shqipërinë
- Civil Rights Defenders
- SHKEJ
- Res Publica,
- Shoqata Rome USHTEN

ANEKS 3

ANNEX 3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 3/191-19 Prot.
Nr. Dok. 201501869/19

Tiranë 11/12/2015

Lënda : *Kërkohet informacion*

Drejtuar : **Regjistrueses së Zyrës Vendore të Regjistrimit
të Pasurive të Paluajtëshme, Tiranë.
Zj. Lediana Bardhi**

Tiranë

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, ka filluar shqyrtimin me inisiativë të çështjes së zhvendosjes së familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, një nga problematikat që ka nevojë për saktësim është pronësia mbi sipërfaqen e tokës, në të cilën ishin vendosur barakat e komunitetit Rom/Egjiptian, në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës. Nga të dhënat e pjesëshme që ne disponojmë, zona në të cilën ishte vendosur ky komunitet përfshihet në zonën kadastrale nr.8280, ku edhe bën pjesë pasuria nr.1/410, volum 2, faqe 178. Kemi evidentuar këtë pasuri private, pasi e kemi të vërtetuar se në të ka patur një barakë të një familjeje rome.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhe kërkojmë nga ana juaj vënien në dispozicion të një kopjeje të fragmentit të hartës treguese të regjistrimit, në të cilën të pasqyrohet sipërfaqja e tokës me këto kufizime; Veri-Liqeni Artificial, Jug- Rrugë automobilistike, Lindje dhe Përendim- Tokë (me pronarë shtet ose privat).

Këtë kërkesë për informacion e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se; "organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe në gërmën "b", të nenit 19, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përkatësisht thuhet shprehimisht se;

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë

- të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

..."Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon procedimin, hapat konkrete të ndërmarre prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.



Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".


Këtë informacion, lutemi të n'a e dërgoni në një kohë sa më të shpejtë të mundshme nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISË

ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË

Nr. 39374/1 Prot.
(lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 06/01/2016

Lenda: **Kerkese per informacion**

Drejtuar: **AVOKATI POPULLIT**

TIRANË

Ne pergjigje te shkreses tuaj nr. k3/i91-19 Prot, dt. 11.12.2015, e regjistruar ne zyren tone me nr. 39374 Prot, dt. 11.12.2015, "Kerkohet Informacion" pas shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor ju informojme se:


- 1- Pasuria nr. 1/410, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Florian Bodinaku.
- 2- Pasuria nr. 1/116, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Ismail Balla.
- 3- Pasuria nr. 1/115, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Naim Balla.
- 4- Pasuria nr. 1/114, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Ervis Balla BP.
- 5- Pasuria nr. 1/300, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Shtet.
- 6- Pasuria nr. 1/302, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Shtet.
- 7- Pasuria nr. 1/111, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Agron Balla BP.
- 8- Pasuria nr. 1/112, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Qerime Balla BP.
- 9- Pasuria nr. 1/113, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Bedrije Guzja.
- 10- Pasuria nr. 1/110, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Qefsere Brahja BP.
- 11- Pasuria nr. 1/109, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Fatos Bodinaku BP.
- 12- Pasuria nr. 1/409, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Florian Bodinaku.
- 13- Pasuria nr. 1/125, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Fatos Bodinaku.
- 14- Pasuria nr. 1/126, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Pranvera Bodinaku.
- 15- Pasuria nr. 1/127, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Roland Bodinaku.
- 16- Pasuria nr. 1/128, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Yllbardh Bodinaku.
- 17- Pasuria nr. 1/129, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Gani Bodinaku.
- 18- Pasuria nr. 1/73, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Ahmet Xibri BP.
- 19- Pasuria nr. 1/427, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Shtet.
- 20- Pasuria nr. 1/392, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Kujtim Xibri.
- 21- Pasuria nr. 1/391, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Selman Xibri.
- 22- Pasuria nr. 1/390, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Ahmet Xibri.
- 23- Pasuria nr. 1/389, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Dylbere Xibri BP.
- 24- Pasuria nr. 1/388, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Rukije Xibri.
- 25- Pasuria nr. 1/406, Zk. 8280 eshte ne pronesi te Gazmend Shkodra.

Bashkelidhur po ju dergojme nje kopje te hartes treguese te pasurive te sipercituara.

Faleminderit per mirekuptimin!

Konceptoi:

Miratoi:



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË**

**REGJISTRUES
Lediana Bardhi**

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE **8280**

NR. I PASURISE: **1/410**

VOL **2**

FQ **178**

INDEKSI I HARTES: **TR-Y-12**

SHKALLA: **1:2500**

ADRESA E PASURISE: Rrethi **Tirane**

Q/F **Tirane**

Rr/L: **LIQ.ARTIFICIAL**

P/G

SH

K **___** Ap

B. KUFIZIMET

V. _____
L. _____
J. _____
P. _____

C. PRONARI

Florjan Bodinaku


D. Data: **06/01/2016**

Ora: **11:25:34**

Vula/Firma

X: 401204.236
Y: 4575481.171

X: 401683.793
Y: 4575481.171



X: 401204.236
Y: 4575084.296

X: 401683.793
Y: 4575084.296

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

(Fragment)

ZYRA E REGJISTRIMIT
PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES
Lediana Bardhi

Vula/Firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE **8280**

NR. I PASURISE: **1/410**

VOL **2**

FQ **178**

INDEKSI I HARTES: **TR-Y-12**

SHKALLA: **1:1000**

ADRESA E PASURISE: Rrethi **Tirane**

Q/F **Tirane**

Rr/L: **LIQ.ARTIFICIAL**

P/G

SH

K ☐ Ap

B. KUFIZIMET

V. _____

L. _____

J. _____

P. _____

C. PRONARI


Florjan Bodinaku

D. Data: **06/01/2016**

Ora: **11:25:08**

X: 401348.103
Y: 4575362.109

X: 401539.926
Y: 4575362.109



X: 401348.103
Y: 4575203.359

X: 401539.926
Y: 4575203.359

ANEKS 4

ANNEX 4



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *73/591-20* Prot.
Nr. Dok. 201501869/20

Tiranë *11/12/2015*

Lënda : *Kërkesë për caktimin e një eksperti*

Drejtuar : Sekretarit të Përgjithshëm,
të Institucionit të Avokatit të Popullit
z. Fatbardh ZENELAJ

I nderuar z. Zenelaj,

Një nga ankesat e marra në shqyrtim me inisiativë nga ana e institucionit tonë, bazuar në artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, është ajo e zhvendosjes së familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje, një nga problematikat që ka nevojë për saktësim është pronësia mbi sipërfaqen e tokës, në të cilën ishin vendosur barakat e komunitetit Rom/Egjiptian, në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës. Nga të dhënat e pjesëshme që ne disponojmë, zona në të cilën ishte vendosur ky komunitet përfshihet në zonën kadastrale nr.8280, ku edhe bën pjesë pasuria nr.1/410, volum 2, faqe 178. Kemi evidentuar këtë pasuri private, pasi e kemi të vërtetuar se në të ka patur një barakë të një familjeje rome. Për verifikimin e plotë të kësaj pjese të hetimit administrative i jemi drejtuar ZVRPP-së, Tiranë, me një kërkesë për informacion, si dhe sot është marrë kontakt direkt nga ana e ndihmëskomisionerëve z. A.Gjoleka dhe z. A. Jaupi, me përfaqësues të kësaj zyre.

Nga shpjegimet e marra (gjë që do të konfirmohet edhe në shkresën zyrtare që do të na dërgohet), rezulton se nevojitet marrja e një eksperti topograf të licensuar, i cili do të bëjë përcaktimin e saktë të statusit të pronësisë të sipërfaqes së tokës, si dhe sipërfaqen konkrete të tokës, ku ishte vendosur komuniteti Rom/Egjiptian.

Në këto rrethana, i është propozuar Avokatit të Popullit, nevoja e thërritjes së një eksperti nga ana jonë, që të mund të gjykojnë objektivisht dhe profesionalisht mbi këtë çështje.


Ky propozim është miratuar prej tij, sikurse edhe ju jeni tashmë në dijeni.

Në këto rrethana do t'ju luteshim që në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi të mundësohej thirrja e një eksperti të pavarur të fushës, që do të jepte një gjykim më objektiv për çështjen.

Kjo kërkesë lidhet me ezaurimin e një procedure të domosdoshme hetimore, me qëllim që të vazhdohet me shqyrtimin e mëtejshëm, përfundimtar të kësaj ankese.

Ndihmëskomisionerët

Alket JAUPI



11.12.2015



Arben GJOLEKA



AKT EKSPERTIMI TEKNIK
PER AZHORNIMIN E ISH VENDQENDRIMIT
TE KOMUNITETIT ROM

AKT EKSPERTIMI TEKNIK

TAULANT shpk

Rruga Gjik Kuqali

Pal. 23/2

Shk.1, Ap.1

Tirane.

E-Mail : shpk.taulant2@gmail.com Cel: 0682032814



NIPT: K61617040L

**AKT EKSPERTIMI TEKNIK
PER AZHORNIMIN E
ISH VENDQENDRIMIT TE KOMUNITETIT
ROM**



POROSITËS: INSTITUCIONI I AVOKATIT TE POPULLIT

TAULANT shpk



Tiranë, __. __. 2016

TAULANT shpk

(NUIS) K61617040L. Adresa: Rruga "Gjike Kuqali", pallati 23/2, shk.1, ap. 1, Tiranë

shpk.taulant2@gmail.com

mobil: +355 68 2032814

HYRJE

Unë që përgatis këtë Akt – Ekspertimi Teknik, me kërkesë të Institucionit Te Avokatit Te Popullit, jam TAULANT shpk, mbajtës i titullit ‘sherbime konsulence, projektim, supervizion, që nga viti 2005, e regjistruar pranë organeve tatimore me numër identifikimi (NUIS) K61617040L, me adrese: rruga “Gjike Kuqali”, p. 23/2, shk.1, ap.1, Tiranë, numër kontakti +355 682032814, adresë E-mail: shpk.taulant2@gmail.com.

Kerkesat e parashtruara nga Institucioni I Avokatit Te Popullit ishin :

1. **Azhornimi ne terren i siperfaqjes dhe pozicionit faktik te perdorur nga komuniteti rom si vendqendrim i perkoheshem.**
2. **Paraqitja e ketij vendqenrimi mbi harten kadastrale te zones**

Ky Akt - Ekspertimi është i përdorshëm vetëm nga ju.. Sigurisht që ekspertimi, mund të konsultohet nga këshilltarë të tjerë profesionistë për t’ju ndihmuar lidhur me çështjen, por jo ndonjë person tjetër jashtë profesionit e interesit. As i tërë dhe asnjë pjesë e këtij raporti ose referencë ndaj tij nuk mund të përfshihet në ndonjë dokument të botuar, qarkore ose deklaratë, pa miratimin tim me shkrim.

DOKUMENTAT KU JAM MBËSHTETUR PER HARTIMIN E DY TETYRAVE


1. ***Per azhornimin ne terren te siperfaqjes dhe pozicionit faktik te perdorur nga komuniteti rom si vendqendrim i perkoheshem u perdor nga ana jone instrumenti GPS (Sokkia GRX-1) i cili garanton saktesine maksimale ne***



percaktimin e pozicionit ne koordinata UTM dhe koordinata gjeografike shteterore me te cilin matem ne vend gjurmen e ish vendqendrimit dhe . Pasi matem ne terren te gjithe gjurmen e ketij ish vendqendrimi u perpunuan te dhenat nga ku rezultoj se:

- Siperfaqja e perdorur si vendqendrim nga komuniteti rom eshte e ndare ne dy parcela pasi ne mes te tyre ekziston nje kanal qe e ndan kete vendqendrim ne dy
- Siperfaqjet e perdorura si vendqendrim nga komuniteti rom jane $S1=6000m^2$ dhe $S2=11300^2$

- Per paraqitjen e ketij azhornimi ne hartën kadastrale te zones u perdoren harta ZK 8280 TR e cila eshte ne koordinata UTM mbi te cilen u mbi vendos azhornimi i kryer ne terren. Nga ky perpunim u hartuan plan-rilevimit bashkengjitur ketij dokumenti.



TAULANT shpk



Tiranë 2016

ANEKS 5

ANNEX 5



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *K1/5118-2* Prot.
Nr. Dok. 201501869/2

Tiranë *05/10*/2015

Lënda : *Kërkohet informacion*

Drejtuar : **Bashkisë Tiranë**

Tiranë

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve më të fundit që lidhen me ndërhyrjen që do të ndërmerret nga ana e institucionit tuaj për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 2.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetojnë në këtë zonë, institucioni juaj është angazhuar me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe është pronë publike.

Sipas rubrikës, Bashkia Tiranë ka konstatuar se, problematikat e vendqëndrimit abuziv dhe të paligjshëm të familjeve Rome janë të shumta, ndaj edhe ka vendosur që t'i largojë ato.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me inisiativë të kësaj çështjeje.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, sa i takon masave që janë marrë nga Bashkia Tiranë, për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Paraprakisht kërkojmë të vihemi në dijeni të faktit nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu del e nevojshme të

na sqarohet se si është menduar dhe se si do të zgjidhet problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na dhënë një kopje të njoftimit zyrtar që iu është komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku banojnë, brenda afatit 10 ditor.

Këtë kërkesë për informacion e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se; "organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe në gërmën "b", të nenit 19, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përkatësisht thuhet shprehimisht se;

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë

- të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

..."Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedinin, hapat konkrete të ndërmarre prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.

Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Këtë informacion, lutemi të n'a e dërgoni në një kohë sa më të shpejtë të mundshme nga ana juaj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I118-5 Prot.
Nr. Dok. 201501869/5

Tiranë 12 / 140 / 2015

Lënda : *Kërkesë e përsëritur për informacion*

Drejtuar : **Bashkisë Tiranë**

Tiranë

Sikurse jeni vënë në dijeni me shkresën tonë nr.K1/I118-2 datë 5.10.2015, institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve më të fundit që lidhen me ndërhyrjen që do të ndërmerret nga ana e institucionit tuaj për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 2.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve romë që jetojnë në këtë zonë, institucioni juaj është angazhuar me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe është pronë publike.

Sipas rubrikës, Bashkia Tiranë ka konstatuar se, problematikat e vendqëndrimit abuziv dhe të paligjshëm të familjeve Rome janë të shumta, ndaj edhe ka vendosur që t'i largojë ato.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, ka dalë e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, sa i takon masave që janë marrë nga Bashkia Tiranë, për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Paraprakisht kërkojmë të vihem në dijeni të faktit nëse institucioni juaj ka bërë

një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu ka dalë e nevojshme të na sqarohet se, si është menduar dhe se si do të zgjidhet problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na dhënë njëkohësisht një kopje të njoftimit zyrtar që iu është komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku banojnë, brenda afatit 10 ditor.

Këtë kërkesë për informacion e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se; "organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe në gërmën "b", të nenit 19, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përkatësisht thuhet shprehimisht se;

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë

- të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

..."Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon procedimin, hapat konkrete të ndërmarre prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.

Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Përmes kësaj kërkesë të përsëritur lutemi që, informacionin e kërkuar për shkak të emergjencës së shfaqur në problematikat e shfaqura gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, të n'a e dërgoni në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/191-8 Prot.
Nr. Dok. 201501869/8

Tiranë 29.10/2015

Lënda : Kërkesë e përsëritur për informacion

Drejtuar : Bashkisë Tiranë

Tiranë

Sikurse jeni vënë në dijeni me shkresën tona nr.K1/I118-2 datë 5.10.2015 dhe nr. K1/I118-5 datë 12.10.2015, institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve më të fundit që lidhen me ndërhyrjen që do të ndërmerret nga ana e institucionit tuaj për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 2.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetojnë në këtë zonë, institucioni juaj është angazhuar me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe është pronë publike.

Sipas rubrikës, Bashkia Tiranë ka konstatuar se, problematikat e vendqëndrimit abuziv dhe të paligjshëm të familjeve Rome janë të shumta, ndaj edhe ka vendosur që t'i largojë ato.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me inisiativë të kësaj çështjeje.

Mbi këtë bazë, kemi kërkuar paraprakisht nga ana e institucionit tuaj dhënien e shpjegimeve, sa i takon masave që janë marrë nga Bashkia Tiranë, për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Për këtë qëllim kemi kërkuar të vihem në

dijeni të faktit nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu kemi kërkuar të na sqarohet se, si është menduar dhe se si do të zgjidhet problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na dhënë njëkohësisht një kopje të njoftimit zyrtar që iu është komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku banojnë, brenda afatit 10 ditor.

Përmes shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, në Bashkinë Tiranë, jemi vënë në dijeni me një gjuhë të përgjithshme se, institucioni juaj ka marra masa sa i takon 48 familjeve rome të ardhura nga Bashkitë Elbasan, Berat, Bilisht, Pogradec, që jetonin në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë, përmes një procesi që ka mundësuar dhe do të mundësojë:

- Vlerësimin social të fëmijëve dhe familjeve për çdo familje,
- Hartimin e planeve individuale për çdo familje,
- Zbatimin e planeve individuale të ndërhyrjes, referimin dhe ndjekjen,
- Transferimin e familjeve nga vendbanimet aktuale në vendin e origjinës, apo vendbanime alternative në Bashkinë e Tiranës.

Sipas shkresës suaj janë vendosur marrëdhëniet e bashkëpunimit me bashkitë reciproke ku familjet në fjalë janë të regjistruara, ndërkohë që, për familjet e mbetura thuhet se është kërkuar zyrtarisht mundësia për strehimin e tyre në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, si dhe Strehim në banesa private mbështetur në Programet e Strehimit të Bashkisë Tiranë, përkatësisht Bonusi i Strehimit, ku pjesa më e madhe e qerasë do të subvencionohet nga buxheti i vet Bashkisë Tiranë.

Në vazhdim të shqyrtimit të kësaj çështjeje nga ana jonë, del e nevojshme të na jepet një informacion i detajuar lidhur me:

1. Studimin paraprak që i ka paraprirë këtij procesi dhe që lidhet me përcaktimin e gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim nga ana e Bashkisë Tiranë, që institucioni juaj ka kryer për këtë rast. Një kopje e këtij dokumenti zyrtar të na dërgohet bashkëngjitur përgjigjes suaj.
2. Kopjen e akteve zyrtare mbi bazën e të cilave është filluar dhe ka përfunduar procesi i zhvendosjes së familjeve rome/egjiptiane, nga zona e Liqenit Artificial, Tiranë. Megjithëse nga ana jonë në shkresat e mëparshme është kërkuar fillimisht, kopja e njoftimit zyrtar që iu është komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku banojnë brenda afatit 10 ditor, përsëri kjo kopje dokumenti zyrtar nuk është dërguar nga ana juaj.
3. Kopjen e marrëveshjeve apo shkresave të komunikimit zyrtar me Bashkitë Elbasan, Pogradec, Berat dhe Bilisht, sa i takon transferimit të familjeve nga vendbanimet aktuale në vendin e origjinës, ku edhe parashikohen të gjitha masat respektive për çdo familje, sipas kriterëve të konfirmuara në shkresën tuaj.
4. Numrin dhe emrat e kryefamiljarëve të familjeve të mbetura, që nuk kanë ardhur nga bashki të tjera, për të cilat është kërkuar zyrtarisht mundësia për strehimin e tyre në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, si dhe Strehimi në banesa private mbështetur në

Programet e Strehimit të Bashkisë Tiranë, përkatësisht Bonusi i Strehimit, ku pjesa më e madhe e qerasë do të subvencionohet nga buxheti i vet Bashkisë Tiranë. Ky informacion duhet të shoqërohet me kopje të dokumenteve zyrtare që konfirmojnë kërkesën për strehimin në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, si dhe procesin e vendimmarrjes për trajtim me strehim alternative sipas Programeve të Strehimit të Bashkisë Tiranë, përkatësisht Bonusit të Strehimit, të këtyre familjeve.

Këtë kërkesë për informacion e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se; "organet dhe funksionarët publike janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij", si dhe në gërmën "b", të nenit 19, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përkatësisht thuhet shprehimisht se;

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë

- të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

..."Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkrete të ndërmarre prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.


Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Përmes kësaj kërkesë të përsëritur lutemi që, informacionin e kërkuar për shkak të emergjencës së shfaqur në problematikat e shfaqura gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, të n'a e dërgoni në një kohë sa më të shpejtë të mundshme.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermir KAPEDANI






BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. prot. 14399/

Tiranë 16/10/2015

Drejtuar: **Z. Emir Kapedani**
Komisioner
Avokati i Popullit
Tiranë



Lënda: **Kthim përgjigje.**

I nderuar z. Kapedani,

Bashkia e Tiranës në ndjekje të planit të vet të masave për zhvillimin e një sistemi të kombinuar të mirëqenies sociale në nivel vendor, pjesë e së cilës është bërë edhe sistemimi i familjeve që jetojnë në kushte jo të përshtatshme në zonën e Parkut të Liqenit Artificial ju bën me dije sa më poshtë:

Në zgjidhje të situatës së gjendur në Parkun e Liqenit Artificial, ku prej vitesh jetojnë në kushte tejet të papërshtatshme 48 familje rromë të ardhura nga Bashkitë Elbasan, Berat, Bilisht, Pogradec, u ndërmorr një nismë për sistemimin e këtyre familjeve në kushte më të mira banimi dhe jetese.

Mbështetur në një plan ndërhyrjeje të detajuar, në bashkëpunim me partnerët tanë nga institucionet homologe dhe të linjës si dhe partnerët nga shoqëria civile, ky proces ka mundësuar dhe do të mundësojë:

1. Vlerësimin social të fëmijëve dhe familjeve për çdo familje.
2. Hartimin e planeve individuale për çdo familje.
3. Zbatimin e planeve individuale të ndërhyrjes, referimin dhe ndjekjen.
4. Transferimin e familjeve nga vendbanimet aktuale në vendin e origjinës apo vendbanime alternative në Bashkinë e Tiranës.

Në verifikimet e kontaktet e herëpashershme në komunitet të familjeve, stafet e specializuara të Bashkisë së Tiranës, NJMF-të, të mbështetur nga organizatat ofruese të shërbimeve të këtij komuniteti, ARSIS, Terre des hommes, Save the Children, ShKEJ, kanë vlerësuar gjendjen social-ekonomike të familjeve duke synuar edhe vendosjen e bashkëpunimit të vetë familjes në procesin e sistemimit dhe riintegritit të tyre të mëtejshëm, përmes marrjes së përgjegjësisë përkatëse.

Ndërkohë janë vendosur marrëdhëniet e bashkëpunimit edhe me bashkitë reciproke ku familjet janë të regjistruara dhe departamentet sociale në këto bashki janë angazhuar të asistojnë të gjitha procedurat, logjistikën dhe me financat e nevojshme përgjatë këtij procesi në pritje të këtyre familjeve.

Në këtë rrjedhë ditësh, disa prej familjeve janë larguar me vullnetin e tyre drejt vendbanimeve të origjinës, ndërkohë që për familjet e mbetura është kërkuar zyrtarisht mundësia për strehimin të disa familjeve në Qendrën Tranzitore të Emergjencës, kjo për ato familje që nuk kanë asnjë të ardhur, si dhe strehim në banesa private mbështetur në Programet e Strehimit të Bashkisë së Tiranës, përkatësisht Bonusi i Strehimit, ku pjesa më e madhe e qerasë do të subvencionohet nga buxheti i vetë Bashkisë së Tiranës.

Në vazhdimësi të ndjekjes së këtyre problematikave, stafet e shërbimit social në Bashkinë e Tiranës (përfshirë këtu dhe qendrat sociale) si dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF), kanë përgjegjësinë që për rastet për të cilat është marrë vendimi dhe plani parashikon një transferim në bashkinë e origjinës, rasti do të referohet me dokumentacionin e nevojshëm për tek departamenti i shërbimit social pranë bashkisë përkatëse, ndërsa për rastet që do të vendosen brenda territorit administrativ që ato mbulojnë, do të ndiqet i tërë procesi për sigurimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të tyre.

Me respekt,

Drejtore i Përgjithshëm


Taulant Tusha

ANEKS 6

ANNEX 6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *83/191-14* Prot.
Nr. Dok. 201501869/14

Tiranë *28/10* /2015

Lënda : Kërkesë për shpjegime

Drejtuar : Kryeinspektorit
Policia Bashkiake
Bashkia

TIRANË

I nderuar z. Kryeinspektor!

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve të fundit që lidhen me ndërhyrjen e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 02.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë u angazhua me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe trualli ishte pronë publike. Sipas punonjësve të Bashkisë, familjet rome do të zhvendoseshin në vendet e tyre të origjinës, e më konkretisht në Elbasan, Berat, Pogradec dhe Bilisht.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Pas zhvendosjes së familjeve nga kampi ku kishin jetuar prej vitesh drejt vendeve të tyre të origjinës apo qendra të tjera banimi, ka rezultuar se një pjesë e familjeve rome janë rikthyer sërish në afërsi të kampit ku kanë jetuar, pasi në vendet ku janë vendosur përkohësisht, nuk kanë patur dhe nuk

u janë siguruar kushtet minimale të jetesës dhe strehimit. Konkretisht rezulton se gjashtë familjet rome janë vendosur në një truall privat, në pronësi të shtetasve Brahja. Ndërkohë që pas inspektimit të kushteve të jetesës së këtyre familjeve nga ekspertë të Avokatit të Popullit me datë 28.10.2015, anëtarët e këtyre familjeve janë shprehur se kanë patur prësione dhe u është dhënë ultimatum nga ana e punonjësve të policisë bashkiake për lirin e truallit privat ku ishin vendosur me mirëkuptimin dhe miratimin e shtetasit Hysni Brahja.

Për nevojat të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana Juaj lidhur me faktet:

- a) nëse ka patur verifikime nga punonjës të Policisë Bashkiake Tiranë të situatës së familjeve rome të vendosura në një truall privat, në afërsi të kampit ku kanë jetuar më përpara;
- b) cilat janë aktet dhe baza ligjore e verifikimit të kryer, si dhe e kërkesave për lirin e truallit;
- c) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura.

Këtë kërkesë për shpjegime e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në gërmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", ku përkatësisht thuhet shprehimisht se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) "të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Gjithashtu, bazuar në gërmën "c", të pikës 2, të nenit 45, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *"Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga proçedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një proçedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe: - Avokati i Popullit"*.

Sa më sipër, duke qenë se ka filluar një proçedim administrativ dhe duke qenë se për vete trajtimin ligjor të çështjes, ne jemi tashmë pjesmarrës në të, na lind e drejta të njihemi me trajtimin përkatës dhe dokumentacionin e kësaj çështjeje, si dhe të marrim pjesë aktive në proçedurat në zhvillim, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

"...Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkrete të ndërmarrë prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.



Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Lutemi bashkëngjitur të na dërgoni edhe dokumentacionin ligjor që ka lidhje me çështjen e parashtruar sa më sipër, me qëllim të indentifikimit sa më të shpejtë të problemit të parashtruar.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

KOMISSIONER

Ermir KAPEDANI






**BASHKIA
TIRANË**
POLICIA BASHKIAKE

Nr. prot. 16323/

24.12 2015

Drejtuar: **Z. Ermir Kapedani**
Komisioner
Avokati i Popullit
Tiranë



Lënda: **Kthim përgjigje**

E nderuar z. Kapedani,


Në përgjigje të kërkesës suaj, me Nr. K3/I91-1 prot., datë 29.10.2015, ju bëjme me dije se :

Policia Bashkiake nuk ka patur dijeni, si dhe nuk ka qënë pjesë e një Plani Veprimi, për të zhvendosur, pjestarët e komunitetit rom tek Liqeni, në vendet e tjera të origjinës si Elbasan, Berat, etj.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Kryeinspektori i Policisë Bashkiake

Ermal KAPLLANAJ



ANEKS 7

ANNEX 7



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/191-12 Prot.
Nr. Dok. 201501869/12

Tiranë 29/10/2015

Lënda : Kërkesë për shpjegime

Drejtuar : **z. Bledjon Nallbati**
Kryetar i Bashkisë

BILISHT

I nderuar z. Nallbati!

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në mediani audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve të fundit që lidhen me ndërhyrjen e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 02.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë u angazhua me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe trualli ishte pronë publike. Sipas punonjësve të Bashkisë, familjet rome do të zhvendoseshin në vendet e tyre të origjinës, e më konkretisht në Elbasan, Berat, Pogradec dhe Bilisht.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Në këtë kuadër, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni jonë të kësaj çështjeje, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, përsa u përket shqetësimeve që po ndiqen në vijimësi nga ana e institucionit

të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e strehimit të familjeve rome, por jo vetëm, si edhe të gjendjes së kushteve të jetesës në kampet ku ata mund të jenë vendosur tashmë në territorin në administrimin tuaj.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana Juaj lidhur me faktet:

- a) nëse ka patur marrëveshje paraprake mes Bashkisë Bilisht dhe Bashkisë Tiranë lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rome;
- b) nëse ka familje rome të zhvendosura nga kampi i Liqenit Artificial i Tiranës dhe që janë vendosur tashmë në Bilisht;
- c) cilat janë masat që janë marrë nga Bashkia Bilisht për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për strehim për këto familje rome;

ç) cila janë procedurat dhe veprimet që po ndiqen nga strukturat sociale të Bashkisë Bilisht lidhur me integrimin dhe krjimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në vendet ku janë vendosur tashmë këto familje, duke përfshirë arsimimin e fëmijëve, ofrimin e vendeve të punës, përfshirjen në programet e ndryshme sociale të strehimit apo ndihmës ekonomike;

d) nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve dhe nëse janë evidentuar konkretisht numri dhe gjendja e familjeve të vendosura në Bashkinë Bilisht;

dh) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura. Këtë kërkesë për shpjegime e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në gërmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, ku përkatësisht thuhet shprehimisht se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) "të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Gjithashtu, bazuar në gërmën "c", të pikës 2, të nenit 45, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *"Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga proçedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një proçedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe: - Avokati i Popullit"*.

Sa më sipër, duke qenë se ka filluar një proçedim administrativ dhe duke qenë se për vete trajtimin ligjor të çështjes, ne jemi tashmë pjesëmarrës në të, na lind e drejta të njihemi me trajtimin përkatës dhe dokumentacionin e kësaj çështjeje, si dhe të marrim pjesë aktive në proçedurat në zhvillim, në perputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

"...Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkrete të ndërmarrë prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.


Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Lutemi bashkëngjitur të na dërgoni edhe dokumentacionin ligjor që ka lidhje me çështjen e parashtruar sa më sipër, me qëllim të indentifikimit sa më të shpejtë të problemit të parashtruar.


Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

KOMISIONERE

Etilda GJONAJ (SALIU)



20.10.2011






REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA DEVOLL
SEKTORI I ARSIMIT DHE KULTURES

Nr. 680 Prot.

Bilisht më, 02.11.2015

Lënda: Kthim pergjigje .



Drejtuar: Avokatit te Popullit,

TIRANE.

Ne pergjigje te shkreses tuaj Nr.K3/191-12Prot., Nr. Dok.201501869/12, "Kerkese per shpjegime ne lidhje me familjet e komunitetit Rom te cilat jetonin prej kohesh ne zonen prane liqenit Artificial te Tiranës"ju bejme me dije se : Referuar rubrikes "Bashkia e Tiranës plan veprimi per te zhvendosur Romet tek Liqeni" konstatuam se gjendet nje familje me kryefaminljar, Leonard Flamur Shoshari , bashkeshorten dhe tre femije. Kjo familje eshte vendosur ne rregjistrat e gjendjes civile ne Bilisht me date 20.06.2006.Para kesaj date kane qene te vendosur ne Cerave te Pogradecit. Leonardi me date 26.09.2011 ka ndrim mbiemri nga Zerellari ne Shoshari. Familja Zerellari nuk ka qene asnjehere rezidente ne qytetin e Bilishtit, per pasoje kjo familje nuk eshte trajtuar me asnje nga programet sociale te strehimit sepse nuk ka depozituar asnjehere prane Bashkise kerkesen dhe dokumentacionin e nevojshem per strehim.

DEKRETI

Bashkenlidhur keni dhe certifikaten e kesaj familje.

Duke ju falenderuar per bashkepunimin!

Kryetari i Bashkisë Devoll
Bledjon Nallbati



008458045

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia Devoll
Njësia administrative Bilisht 272
Zyra e Gjendjes Civile Bilisht



ÇERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Date: 02.11.2015

Nr.	Emri e mbiemri	Emri i babait	Emri i nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri personal
1.	Leonard SHOSHARI	Flamur	Natasha	M	KRYEFA.	15-03-1981	I/e martuar	MifoI, Vlorë	Shqipëri	1103150341
2.	Miranda ZERELLARI	Fahik	Farije	F	BASHKË.	16-10-1980	I/e martuar	Bilisht, Devoll	Shqipëri	106016022P
3.	Kostandin SHOSHARI	Leonard	Miranda	M	I BIRI	30-04-1999	Beqar/e	Qershize, Korce	Shqipëri	J904330027U
4.	Dina SHOSHARI	Leonard	Miranda	F	E BILJA	01-09-2012	Beqar/e	Bilisht, Devoll	Shqipëri	L25901008E
5.	Ergit SHOSHARI	Leonard	Miranda	M	I BIRI	23-11-2003	Beqar/e	Selanik, Greqi	Shqipëri	K31123080F
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										
11.										
12.										
13.										
14.										
15.										

Kjo çertifikatë lëshohet për
zyrtare, vendosje familjare me date 20.06.2006 nga
Çetara me date 26.09.2011 ka ndrim mbiemri nga
Zerellari ne Shoshari

Nëpunësi i Gjendjes Civile
ALBANA MUSO

(Emri, mbiemri, nënshkrimi, vula)

ANEKS 8

ANNEX 8



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 23/191-10 Prot.
Nr. Dok. 201501869/10

Tiranë 29/10/2015

Lënda : Kërkesë për shpjegime

Drejtuar : z. Petrit Sinaj
Kryetar i Bashkisë

BERAT

I nderuar z. Sinaj!

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve të fundit që lidhen me ndërhyrjen e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 02.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë u angazhua me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe trualli ishte pronë publike. Sipas punonjësve të Bashkisë, familjet rome do të zhvendoseshin në vendet e tyre të origjinës, e më konkretisht në Elbasan, Berat, Pogradec dhe Bilisht.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Në këtë kuadër, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni jonë të kësaj çështjeje, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, përsa u përket shqetësimeve që po ndiqen në vijimësi nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e strehimit të familjeve rome, por jo

vetëm, si edhe të gjendjes së kushteve të jetesës në kampet ku ata mund të jenë vendosur tashmë në territorin në administrimin tuaj.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana Juaj lidhur me faktet:

- a) nëse ka patur marrëveshje paraprake mes Bashkisë Berat dhe Bashkisë Tiranë lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rome;
- b) nëse ka familje rome të zhvendosura nga kampi i Liqenit Artificial i Tiranës dhe që janë vendosur tashmë në Berat;
- c) cilat janë masat që janë marrë nga Bashkia Berat për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për strehim për këto familje rome;

ç) cila janë procedurat dhe veprimet që po ndiqen nga strukturat sociale të Bashkisë Berat lidhur me integrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në vendet ku janë vendosur tashmë këto familje, duke përfshirë arsimimin e fëmijëve, ofrimin e vendeve të punës, përfshirjen në programet e ndryshme sociale të strehimit apo ndihmës ekonomike;

d) nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve dhe nëse janë evidentuar konkretisht numri dhe gjendja e familjeve të vendosura në Bashkinë Berat;

dh) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura. Këtë kërkesë për shpjegime e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në gërmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, ku përkatësisht thuhet shprehimisht se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) "të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Gjithashtu, bazuar në gërmën "c", të pikës 2, të nenit 45, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *"Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga proçedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një proçedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe: - Avokati i Popullit"*.

Sa më sipër, duke qenë se ka filluar një proçedim administrativ dhe duke qenë se për vete trajtimin ligjor të çështjes, ne jemi tashmë pjesmarrës në të, na lind e drejta të njihemi me trajtimin përkatës dhe dokumentacionin e kësaj çështje, si dhe të marrim pjesë aktive në proçedurat në zhvillim, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

"Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkrete të ndërmarrë prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.



Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Lutemi bashkëngjitur të na dërgoni edhe dokumentacionin ligjor që ka lidhje me çështjen e parashtruar sa më sipër, me qëllim të indentifikimit sa më të shpejtë të problemit të parashtruar.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

KOMISIONERE

Etilda GJONAJ (SALIU)





BASHKIA BERAT


Tel : 00355 (0) 2 32 34 935 / Fax : 00355 (0) 2 32 34 036

bashkiaberat.gov.al

Email : bashkiaberat@yahoo.com

Adresa : Blvd. 'Republika', Berat, Shqipëri

Nr prot



Nr 3/1591/prot

Berat me 06.11.2015

Lenda : Kthim pergjigje

Per : Z.Etilda GJONAJ (SALIU)

Komisionere prane Avokatit te Popullit

TIRANE

Ne pergjigje te shkreses suaj date 29..10.2015 ju sqarojme se :

Ne lidhje me shpernguljen e disa familjeve rome nga Tirana per ne Berat ne jemi njoftuar nga Bashkia Tirane nepermjet email per numrin dhe listen e plote te familjeve. Jane gjithsej 19 familje qe kane te drejten e banimit ne Berat por nga keto 4 familje nuk kane jetuar asnjehere ne Berat.

Midis Bashkise Berat e Bashkise Tirane nuk ka Mareveshje paraprake per rikthimin e familjeve rome.

Me marjen e informacionit Drejtoria e Sherbimit Social Bashkia Berat me specialistin e NJMF e te Komunitetit rom e egjyptian verifikuan ne terren nese keto familje kishin kushtet e banimit per tu kthyer ne Berat. Ne perfundim rezultoi se 10 prej tyre kane banesa per te jetuar, por ne kushte jo te mira dhe 2 prej tyre jetojne ne çadra ndersa 5 prej tyre nuk kane banesa ne Berat.

Gjithashtu ka 4 familje qe aktualisht nuk jetojne ne Berat e sipas informacioneve kane emigruar ne Greqi dhe 3 familje kane qendruar ne Tirane.

Ne rast se do tu duhet lista emerore jemi te gatshem tja u veme ne dispozicion.

Faleminderit per mirekuptimin e bashkepunimin.

KRYETARI BASHKISE

Petrit SINAJ



Me date 08.07.2008 qyteti i Beratit me Vendim të Komitetit të Trashëgimisë pranë UNESCO nominohet ne Listën e Trashëgimisë Boterore



ANEKS 9

ANNEX 9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/191-9 Prot.
Nr. Dok. 201501869/9

Tiranë 29/10/2015

Lënda : Kërkesë për shpjegime

Drejtuar : z. Qazim Sejдини
Kryetar i Bashkisë

ELBASAN

I nderuar z. Sejдини!

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve të fundit që lidhen me ndërhyrjen e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 02.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë u angazhua me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe trualli ishte pronë publike. Sipas punonjësve të Bashkisë, familjet rome do të zhvendoseshin në vendet e tyre të origjinës, e më konkretisht në Elbasan, Berat, Pogradec dhe Bilisht.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Në këtë kuadër, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni jonë të kësaj çështjeje, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, përse u përket shqetësimeve që po ndiqen në vijimësi nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e strehimit të familjeve rome, por jo

vetëm, si edhe të gjendjes së kushteve të jetesës në kampet ku ata mund të jenë vendosur tashmë në territorin në administrimin tuaj.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana Juaj lidhur me faktet:

- a) nëse ka patur marrëveshje paraprake mes Bashkisë Elbasan dhe Bashkisë Tiranë lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rome;
- b) nëse ka familje rome të zhvendosura nga kampi i Liqenit Artificial i Tiranës dhe që janë vendosur tashmë në Elbasan;
- c) cilat janë masat që janë marrë nga Bashkia Elbasan për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për strehim për këto familje rome;

ç) cila janë procedurat dhe veprimet që po ndiqen nga strukturat sociale të Bashkisë Elbasan lidhur me integrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në vendet ku janë vendosur tashmë këto familje, duke përfshirë arsimimin e fëmijëve, ofrimin e vendeve të punës, përfshirjen në programet e ndryshme sociale të strehimit apo ndihmës ekonomike;

d) nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve dhe nëse janë evidentuar konkretisht numri dhe gjendja e familjeve të vendosura në Bashkinë Elbasan;

dh) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura. Këtë kërkesë për shpjegime e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në gërmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, ku përkatësisht thuhet shprehimisht se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) "të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Gjithashtu, bazuar në gërmën "c", të pikës 2, të nenit 45, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *"Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga proçedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një proçedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe: - Avokati i Popullit"*.

Sa më sipër, duke qenë se ka filluar një proçedim administrativ dhe duke qenë se për vete trajtimin ligjor të çështjes, ne jemi tashmë pjesmarrës në të, na lind e drejta të njihemi me trajtimin përkatës dhe dokumentacionin e kësaj çështjeje, si dhe të marrim pjesë aktive në proçedurat në zhvillim, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

"...Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkrete të ndërmarrë prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.

Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

Etilda GJONAJ (SALIU)



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN**


Adresa: BashkiaElbasan,Rr"Q.Stafa",Tel:+355 54 400152, bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al

Nr. 6049 Prot.

Elbasan 09.11.2015

Lenda: Kthim Pergjigje

Drejtuar: Institucionit te Avokatit te Popullit



Ne pergjigje te kerkeses suaj Nr. K3/191-9 Nr.Dok.201501869/9 per shpjegime ne lidhje me ceshtjen e zhvendosjes se familjeve rome nga kampi i Liqenit Artificial drejt vendeve te tyre te origjines ju bejme me dije se :

- a) Në institucionin tone nuk na ka ardhur asnje komunikim zyrtar dhe si rrjedhoje nuk mund te kemi as marrveshje paraprake zyrtare ne lidhje me kete ceshtje me Bashkine e Tiranes;
- b) Sipas verifikimeve qe u bene ne te gjashte Njesite Administrative te Bashkise Elbasan u konstatua se nuk eshte paraqitur asnje rast i familjeve rome qe eshte zhvendosur nga kampi i Liqenit Artificial ne Elbasan.
- c) Si rrjedhoje e fakteve qe permendem me larte Bashkia Elbasan nuk ka ndonje strategji apo plan ne lidhje me keto familje por Bashkia Elbasan gjithmone ka qene dhe vazhdon te jete e gatshme per tju ardhur ne ndihme familjeve rome ne pergjigje te kerkesave qe ata kane patur , kerkesa te cilat jane permbushur duke realizuar projekte si:
 - Rikonstruksion i shtepive
 - Mbeshtetje finaciare per vetpunesim
 - Mbeshtetje me medikamente, veshmbathje, ushqime etj

Ju falenderojme per bashkepunimin

Kryetari
Qazim SEJDINI

ANEKS 10

ANNEX 10



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/191-11 Prot.
Nr. Dok. 201501869/11

Tiranë 29/10/2015

Lënda : Kërkesë për shpjegime

Drejtuar : z. Eduard Kapri
Kryetar i Bashkisë

POGRADEDEC

I nderuar z. Kapri!

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve të fundit që lidhen me ndërhyrjen e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 02.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë u angazhua me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe trualli ishte pronë publike. Sipas punonjësve të Bashkisë, familjet rome do të zhvendoseshin në vendet e tyre të origjinës, e më konkretisht në Elbasan, Berat, Pogradec dhe Bilisht.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Në këtë kuadër, për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni jonë të kësaj çështjeje, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, përsa u përket shqetësimeve që po ndiqen në vijimësi nga ana e institucionit

të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e strehimit të familjeve rome, por jo vetëm, si edhe të gjendjes së kushteve të jetesës në kampet ku ata mund të jenë vendosur tashmë në territorin në administrimin tuaj.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana Juaj lidhur me faktet:

- a) nëse ka patur marrëveshje paraprake mes Bashkisë Pogradec dhe Bashkisë Tiranë lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rome;
- b) nëse ka familje rome të zhvendosura nga kampi i Liqenit Artificial i Tiranës dhe që janë vendosur tashmë në Pogradec;
- c) cilat janë masat që janë marrë nga Bashkia Pogradec për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për strehim për këto familje rome;

ç) cila janë procedurat dhe veprimet që po ndiqen nga strukturat sociale të Bashkisë Pogradec lidhur me integrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës në vendet ku janë vendosur tashmë këto familje, duke përfshirë arsimimin e fëmijëve, ofrimin e vendeve të punës, përfshirjen në programet e ndryshme sociale të strehimit apo ndihmës ekonomike;

d) nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve dhe nëse janë evidentuar konkretisht numri dhe gjendja e familjeve të vendosura në Bashkinë Pogradec;

dh) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura. Këtë kërkesë për shpjegime e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në gjurmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, ku përkatësisht thuhet shprehimisht se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) "të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Gjithashtu, bazuar në gjurmën "c", të pikës 2, të nenit 45, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *"Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga proçedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një proçedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe: - Avokati i Popullit"*.

Sa më sipër, duke qenë se ka filluar një proçedim administrativ dhe duke qenë se për vete trajtimin ligjor të çështjes, ne jemi tashmë pjesëmarrës në të, na lind e drejta të njihemi me trajtimin përkatës dhe dokumentacionin e kësaj çështjeje, si dhe të marrim pjesë aktive në proçedurat në zhvillim, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

"...Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon proçedimin, hapat konkrete të ndërmarrë prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër."



Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Lutemi bashkëngjitur të na dërgoni edhe dokumentacionin ligjor që ka lidhje me çështjen e parashtruar sa më sipër, me qëllim të indentifikimit sa më të shpejtë të problemit të parashtruar.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj, :


KOMISIONERE

Etilda GJONAJ (SALIU)



Lenda: Informacion

Drejtuar: Avokatit të Popullit



TIRANË

Në mbështetje të shkresës Nr.K3/191-11 Prot. datë 29.10.2015. "Kërkesë për shpërgjime", drejtuar Bashkisë Pogradec, ju informojmë se :

Në lidhje me "Planin e Veprimit të Bashkisë të Tiranës , për të zhvendosur romët tek liqeni", drejt vëndeve të origjinës, ju vemë në dijeni se ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe Bashkisë të Tiranës ka pasur një shkëmbim informacioni . e-mail, për një familje të vetme , si më poshtë:

- Gramoz Flamur Zerellari, kryefamiljari
- Eljane Hysni Zerellari, bashkëshortja
- Dino Gramoz Zerellari, i biri
- Kristina Gramoz Zerellari, e bija.

Bashkia Pogradec mori masat paraprake, duke gjetur origjinën e familjes, nga fshati Qershizë, njësia administrative Çërravë, mori informacion lidhur me banesën dhe pronat që dispononte kjo familje.

Në bazë të informacionit nga Njësia Administrative Çërravë Nr.88 prot. datë 09.11.2015, si dhe nga Zyra Vendore ZRPP Pogradec, nr. 3781/1 datë 10.11.2015 (dokumentacion bashkëngjitur mbritur në Bashki në 26.11.2015) rezulton se kjo familje nuk ka asnjë pronë dhe banesë në fshatin Qershizë.

Familja e Z.Gramoz Zerellari nuk është paracitur të kontaktojë me përfaqësues të Bashkisë Pogradec për të marrë mbështetjen e duhur.

Për strukturat e urbanistikës dhe shtetit në Bashki Pogradec janë kryer studime për familjet romë, për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës të komunitetit rom, dhe janë dërguar e do të vazhdojnë të dërgohen projekte pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin!

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Eduart KAPRI
KRYETAR

ANEKS 11

ANNEX 11



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *43/191-13* Prot.
Nr. Dok. 201501869/13

Tiranë *28/10*/2015

Lënda : Kërkesë për shpjegime

Drejtuar : znj. Etleva BISHA
Shërbimi Social Shtetëror

TIRANË

E nderuara znj. Bisha!

Institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si fushë kryesore të veprimtarisë së tij ka mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të drejtën për mirëqeverisje dhe për strehim të përshtatshëm.

Bazuar në trajtimin e gjerë që institucioni i Avokatit të Popullit i kushton problematikave të respektimit të këtyre të drejtave dhe lirive, nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, jemi vënë në dijeni të zhvillimeve të fundit që lidhen me ndërhyrjen e ndërmarrë nga Bashkia Tiranë për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom, të vendosura prej kohësh në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Më konkretisht, në datën 02.10.2015, në website "Shqiptarja.com" është publikuar një rubrikë me titullin "Bashkia e Tiranës plan veprimi për të zhvendosur romët tek Liqeni". Sipas kësaj rubrike të shoqëruar edhe me fotot e barakave të familjeve rome që jetonin në këtë zonë, Bashkia Tiranë u angazhua me stafin përkatës për zhvendosjen e këtyre familjeve, duke iu dhënë atyre 10 ditë kohë, pasi kjo sipërfaqe trualli ishte pronë publike. Sipas punonjësve të Bashkisë, familjet rome do të zhvendoseshin në vendet e tyre të origjinës, e më konkretisht në Elbasan, Berat, Pogradec dhe Bilisht.

Ndërkohë që një pjesë e familjeve, të cilat kishin gjendjen civile në Tiranë, do të akomodoreshin në Qendrën Kombëtare të Emergjencave Civile.

Sa më sipër, institucioni i Avokatit të Popullit në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj çështjeje.

Në këtë kuadër, për nevojën të shqyrtimit të mëtejshëm nga institucioni jonë të kësaj çështjeje, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana juaj, përsa u përket shqetësimeve që po ndiqen në vijimësi nga ana e institucionit

të Avokatit të Popullit lidhur me kushtet e strehimit të familjeve rome, por jo vetëm, si edhe të gjendjes së kushteve të jetesës në kampet ku ata mund të jenë vendosur tashmë.

Për nevoja të shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj çështjeje nga zyra jonë, del e nevojshme dhënia e shpjegimeve nga ana Juaj lidhur me faktet:

- a) nëse ka familje të ish-kampit rom në afërsi të Liqenit Artificial të Tiranës të cilat janë akomoduar tashmë në QKTE Tufinë;
- b) sa është numri i tyre dhe cilat janë masat konkrete të ndërmarra nga strukturat e SHSSH për trajtimin e tyre social, si edhe për sigurimin dhe garantimin e kushteve të përshtatshme dhe të qëndrueshme për strehim për këto familje rome;
- c) nëse ka patur marrëveshje paraprake mes Bashkisë Tiranë dhe Shërbimit Social Shtetëror lidhur me zhvendosjen e këtyre familjeve rome dhe akomodimin e tyre në QKTE;
- ç) cila janë procedurat dhe veprimet që ndiqen nga strukturat e SHSSH lidhur me pranimin në QKTE, akomodimin, integrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës, periudha e qëndrimit të këtyre familjeve rome në Qendër, si edhe nismat sociale për riintegrimin e tyre në shoqëri, duke patur parasysh faktin se Qendra është tranzitore dhe nuk mund të ofrojë një qëndrim të përhershëm;

d) nëse institucioni juaj ka bërë një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve që kanë jetuar në afërsi të Liqenit Artificial të Tiranës dhe cilat janë problematikat e evidentuara nga strukturat tuaja respektive;

dh) si dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me këtë çështje, duke synuar në sqarimin sa më të shpejtë dhe përfundimtar të shqetësimeve të ngritura. Këtë kërkesë për shpjegime e bazojmë në pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe në gërmën b të nenit 19 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, ku përkatësisht thuhet shprehimisht se:

"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) "të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".

Gjithashtu, bazuar në gërmën "c", të pikës 2, të nenit 45, të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se: *"Në mbrojtje të interesave të gjera, të cilat mund të preken nga proçedimi administrativ, kanë të drejtë të fillojnë një proçedim administrativ dhe/ose të marrin pjesë në të edhe: - Avokati i Popullit"*.

Sa më sipër, duke qenë se ka filluar një proçedim administrativ dhe duke qenë se për vete trajtimin ligjor të çështjes, ne jemi tashmë pjesmarrës në të, na lind e drejta të njihemi me trajtimin përkatës dhe dokumentacionin e kësaj çështjeje, si dhe të marrim pjesë aktive në procedurat në zhvillim, në përputhje me parashikimet ligjore.

Në vazhdim të bazës ligjore, kërkesa bazohet në pikat 2 dhe 3, të nenit 51 të Kodit të Proçedurave Administrative, ku thuhet shprehimisht se:

..."Në informacionin që jepet nga administrata tregohet organi administrativ që zhvillon procedimin, hapat konkrete të ndërmarre prej tij, vendimet e marra si dhe çdo informacion tjetër.


Afati për dhënien e informacionit të parashikuar nga ky nen është 10 ditë, nga dita e regjistrimit të kërkesës përkatëse".

Lutemi bashkëngjitur të na dërgoni edhe dokumentacionin ligjor që ka lidhje me çështjen e parashtruar sa më sipër, me qëllim të indentifikimit sa më të shpejtë të problemit të parashtruar.

Duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, si dhe duke besuar në zbatimin rigoroz të Ligjit nga ana Juaj,

KOMISIONER

Ermir KAPEDANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË


MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
DREJTORIA E KOMISIONIMIT/ MENAXHIMIT TË RASTIT

Nr. 2233/Prot.

Tiranë, më 10.11 2015

Lënda: Kthim Përgjigje

Drejtuar : Z. Ermir Kapedani
Komisioner
AVOKATI I POPULLIT



Tiranë

I nderuar Z. Kapedani,

Në përgjigje të kërkesës suaj me Nr. K3/1 91-13 Prot, datë 29.10.2015 ku kërkonti informacion rreth situatës së familjeve të vendosura në zonën e Liqenit Artificial, për të cilat Bashkia e Tiranës nëpërmjet disa daljeve mediatike ka deklaruar se do t'i zhvendos nga kjo hapësirë nëpërmjet një plani veprimi i cili përfshin disa struktura ndër të cilat edhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave si institucion në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, sqarojmë si më poshtë vijon:

Qendra Tranzitore e Emergjencave e zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të Vendimit Nr.572, datë 24.06.2015, "Për Miratimin e Standarteve të Shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës". Në bazë të standarteve shërbimet në këtë qendër ofrohen në situatat e emergjencës kur familjet nuk janë në gjendje të sigurojnë jetesën e tyre dhe të jenë të pavarura, në situata kur familjet mund të kenë nevojë për ndihmë apo mbështetje emergjence. Ato familje, që kanë veçanërisht nevojë për mbështetje urgjente dhe strehim, janë ato që mbeten të pastrehë dhe detyrohen të jetojnë në rrugë.

Shpjegimet referuar shkresës suaj:

- Aktualisht vetëm një kryefamiljare me dy fëmijë nga zona e liqenit u paraqit në QKTE për të kërkuar akomodim. Pasi ju prezantua rregullorja dhe kushtet e shërbimit në Qendër gruaja pranoi akomodimin në qendër. Familja vijon të marrë shërbim në këtë Qendër.
- Në qendër është akomoduar vetëm një familje me 3 antarë nga komuniteti i sipërcituar. Secila prej familjeve që akomodohej në QKTE nënshkruan një kontratë me drejtuesit e Qendrës ku specifikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve. Qendra merr përsipër strehimin e familjes në një mjedis të përshtatshëm e dinjitoz, gjithashtu garanton shërbim psiko-social për të fuqizuar familjen si dhe asistencë administrativo – ligjore dhe lehtësim të aksesit në shërbimet shëndetësore.
- Shërbimi Social Shtetëror nuk ka një marrëveshje të shkruar me Bashkinë e Tiranës lidhur me situatën e komunitetit të zonës së Liqenit, por kanë pasur një komunikim të vazhdueshëm institucional lidhur

me manaxhimin e situatës së tyre për aq sa i takon kompetencave të secilës palë. Bashkia e Tiranës i ka drejtuar Shërbimit Social Shtetëror disa kërkesa zyrtare, përkatësisht me Nr. 14821 Prot, Nr. 14858 Prot, Nr. 14859 Prot datë 09.10.2015 ku kërkojnë bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për akomodimin e familjeve në situatë të vështirë që aktualisht jetojnë në zonën e Liqenit Artificial pranë Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencave. Në vijim të këtyre kërkesave të Bashkisë së Tiranës në datën 11 tetor 2015, në orën 14.30 pas komunikimit me Bashkinë e Tiranës katër punonjës të QKTE u paraqitën në zonën e liqenit me qëllim informimin paraprak të familjeve për qendrën, rregullat, të drejtat dhe detyrimet e familjeve në qendër etj. Ndërkohë banorët nuk pranuan akomodimin në qendër kryesisht pasi sipas tyre qendra ishte larg vendit të tyre të punës dhe për shkak të marrëdhënieve delikate mes tyre dhe banorëve egzistues të QKTE. Siç shpjegoam në pikën a vetëm një familje në ditët në vijim u paraqit në QKTE dhe tashmë është e akomoduar atje.

- ç. Secila prej familjeve në nevojë akomodohehet në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave bazuar në Vendimin Nr.572, datë 24.06.2015, "Për Miratimin e Standarteve të Shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës". Secila prej familjeve që akomodohehet në QKTE nënshkruan një kontratë me drejtuesit e Qendrës ku specifikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve. Qendra merr përsipër strehimin e familjes në një mjedis të përshtatshëm e dinjitoz, gjithashtu garanton shërbim psiko-social për të fuqizuar familjen si dhe asistencë administrativo – ligjore dhe lehtësim të aksesit në shërbimet shëndetësore. Staf i social i institucionit punon me plan individual për çdo familje për të mundësuar fuqizimin e tyre në përputhje me këto standarte, si dhe duke bashkëpunuar me aktorë të tjerë për të mundësuar fuqizimin e familjes.
- d. Kryerja e vlerësimeve për komunitetet lokale dhe adresimi i nevojave të tyre është detyrë e njësive të pushtetit vendor, pra nuk ka studim të SHSSH për situatën e familjeve të këtij komuniteti. SHSSH reagoi në vijim të kërkesës së drejtuar nga Bashkia e Tiranës dhe ka komunikuar në vijim me këtë njësi të qeverisjes vendore për adresimin e kësaj situatë.

Bashkëngjitur gjeni të gjitha komunikimet e kryera nga dhe për në SHSSH në lidhje me këtë çështje.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.


ETLEVA BISHA
DREKTORI I PËRGJITHSHËM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË RASTIT DHE KOMISIONIMIT

Nr. 2037/Prot.

Tiranë, më 27.10 2015

Lënda: Kthim Përgjigje

Drejtuar : Z. Taulant TUSHA
Drejtor i Përgjithshëm
Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve,
BASHKIA E TIRANËS

Tiranë

I nderuar Z. TUSHA,

Në përgjigje të kërkesave tuaja me Nr. 14821 Prot, Nr. 14858 Prot, Nr. 14859 Prot datë 09.10.2015 ku kërkon bashkëpunimin e Shërbimit Social Shtetëror për akomodimin e familjeve në situatë të vështirë që aktualisht jetojnë në zonën e Liqenit Artificial pranë Qendrës Tranzitore të Emergjencave, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Qendra Tranzitore e Emergjencave e zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të Vendimit Nr.572, datë 24.06.2015, "Për Miratimin e Standarteve të Shërbimeve në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës". Në bazë të standarteve shërbimet në këtë qendër ofrohen në situatat e emergjencës kur familjet nuk janë në gjendje të sigurojnë jetesën e tyre dhe të jenë të pavarura, në situata kur familjet mund të kenë nevojë për ndihmë apo mbështetje emergjence. Ato familje, që kanë veçanërisht nevojë për mbështetje urgjente dhe strehim, janë ato që mbeten të pastrehë dhe detyrohen të jetojnë në rrugë.

Ndërkohë vendosja në QKTE për familjet në situatën e sipërcituar merr për bazë edhe vullnetin e lirë të vetë familjes për ta vlerësuar QKTE si një zgjidhje për situatën e emergjencës në të cilën ndodhet.

Ju informojmë se në vijim të kërkesave tuaja në datën 11 tetor 2015, në orën 14.30 pas komunikimit me institucionin tuaj katër punonjës të QKTE u paraqitën në zonën e liqenit me qëllim informimin paraprak të familjeve për qendrën, rregullat, të drejtat dhe detyrimet e familjeve në qendër etj. **Ndërkohë banorët nuk pranuan akomodimin në qendër kryesisht pasi sipas tyre qendra ishte larg vendit të tyre të punës dhe për shkak të marrëdhënieve delikate mes tyre dhe banorëve egzistues të QKTE.**

Bashkëngjitur gjeni edhe procesverbalin e mbajtur nga stafi i QKTE gjatë vlerësimit si më sipër.

BASHKËTIA E TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT I SHËRBIMIT


Në ditët në vijim një kryefamiljare me dy fëmijë nga zona e liqenit u paraqit në QKTE për të kërkuar akomodim. Pasi ju prezantua rregullorja dhe kushtet e shërbimit në Qender gruaja pranoi akomodimin por njoftoi stafin se do të vendosej pasi të merrte dhe sendet personale të familjes. Aktualisht, gruaja dhe fëmijët nuk janë paraqitur ende në qendër.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.



ETHEVA BISHA

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Handwritten signature and notes

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. prot. 14821

Tiranë 09/10/2015

Drejtuar: **Znj. Etleva Bisha**
Drejtore e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror

Lënda: **Kërkesë për bashkëpunim.**

E nderuar znj. Bisha,

Bashkia e Tiranës në ndjekje të planit të vet të masave për zhvillimin e një sistemi të kombinuar të mirëqenies sociale në nivel vendor, pjesë e së cilës është bërë edhe sistemimi i familjeve që jetojnë në kushte jo të përshtatshme në zonën e Liqenit Artificial, kërkon angazhimin e institucionit tuaj për akomodimin e 15 familjeve pranë Qendrës Kombëtare Tranzitore të Emergjencave.

Lutemi që kjo Qendër të marrë masat e nevojshme për akomodimin, fuqizimin dhe integrimin e këtyre familjeve në komunitet, duke na konsideruar edhe ne partnerë.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe ju urojmë punë të mbarë.

Drejtore e Përgjithshme

Taulant Tusha




BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE MENAXHIMIT TË SHËRBIMEVE

Nr. prot. 14358

Tiranë 8/10/20

Drejtuar: **Znj. Etleva Bisha**
Drejtore e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror



Lënda: **Kërkesë për bashkëpunim.**

E nderuar znj. Bisha,

Bashkia e Tiranës, në vazhdimësi të përmbushjes së planit të ndërhyrjes në sigurim të një jetese në të mirë për anëtarët e komunitetit që banon në zonën e Liqenit Artificial Tiranë, lidhur me kërkesën drejtuar institucionit tuaj për akomodimin e 25 familjeve pranë Qendrës Kombëtare Tranzitore Emergjencave, ju bën me dije një raport të shkurtër mbi situatën social-ekonomike të kësaj komuniteti, gjendur bashkëngjitur.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin dhe ju urojmë punë të mbarë.

Drejtore e Përgjithshme

Taulant Tusha

*Znj. Etleva Bisha
Drejtore e Përgjithshme
Shërbimi Social Shtetëror
13.10.20*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRI E MIREQENIES SOCIALE DHE E RINISE
SHERBIMI SOCIAL SHTETEROR
Qendra Kombetare Tranzitore e Emergjencave

Proces verbal

I mbajtur sot me dt 11.10.2015 ora 14:30,prane vendbanimit te komunitetit rom dhe egjiptian ne zonen e Liqenit Artificial,Tirane.

Ne pergjigje te shkreses se Bashkise Tirane drejtuar Sherbimit Social Shteteror per bashkepunim ne sistemimin e familjeve rome dhe egjiptiane qe jetojne ne kushte jo te pershtatshme ne zonen e Liqenit Artificial,Tirane,stafi i QKTE me perfaqesues ne terren punonjese sociale Sonila Reci, Kujdestar Xheladin Taco,Sokol Mema dhe psikologe Alba Spahiu u paraqit ne kete vendbanim me qellim ofrimin e ambjenteve te institucionit per strehim te perkohshem duke i informuar paraprakisht per rregullat e qendrimit sipas rregullores se qendres.

Pavaresisht tentatives per negociim mes banoreve te komunitetit dhe perfaqesuesve te QKTE si dhe perfaqesuesit te Bashkise se Tiranes Z.Elton Kacidhja,nuk u arrit te finalizohet nje marreveshje pasi banoret shfaqen keto pretendime:

1. Largesia e QKTE nga vendet e punes se tyre
2. Marredheniet delikate mes tyre dhe banoreve aktual te QKTE
3. Sigurim te mjeteve motorike per pune nga ana e shtetit

Pas reagimit agresiv dhe aspak miqesor te komunitetit ndaj stafit te QKTE,u vendos edhe sipas sugjerimit te perfaqesuesit te Bashkise se Tiranes qe stafi te terhiqet.

Stafi i QKTE

Kujdestar

Kujdestar

Punonjese Sociale

Psikologe

Xheladin Taco

Sokol Mema

Sonila Reci

Alba Spahiu

Tirane,Tetor 2015

ANEKS 12

ANNEX 12



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *11/1118-6* Prot.
Nr. Dok. 201501869/6

Tiranë *16/10/2015*

Lënda: Njoftim për ankesën e shtetasit Esat Sinani, anëtar i Komunitetit Rom.

Drejtuar: Z. Ervin HODAJ
Drejtor i Drejtorisë së Policisë

TIRANË

I nderuar Z. HODAJ,

Avokati i Popullit ka filluar me iniciativë shqyrtimin e çështjes së zhvendosjes të banorëve të Komunitetit Rom/Egjiptian në zonën pranë Liqenit Artificial të Tiranës.

Ndër të tjera, nga kontaktet me banorët, na është parashtruar pretendimi se nga punonjës të Bashkisë Tiranë, ju janë dhënë shuma që variojnë nga 10.000-20.000 lek, me qëllim për t'u larguar nga vendbanimi i tyre i përkohshëm në atë zonë. Nga ana jonë nuk është i qartë burimi i këtyre shumave, mënyra e pagesës si edhe shkaku i ligjshëm për të cilin u janë dhënë banorëve këto shuma parash.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të proces verbalit të mbajtur nga Ndhmëskomisionerët e Avokatit të Popullit me njërin nga banorët e Komunitetit Rom/Egjiptian, me qëllim kryerjen e verifikimeve të mëtejshme nga ana e strukturave tuaja.

Në këtë kuadër lutemi të na vini në dijeni mbi procedurat e veprimet konkrete që do të ndiqen për këtë çështje.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.

KOMISIONERE

[Signature]
Etilda GJONAJ (SALIU)

16.10.2015